
SCOOP CIJ-MACEDONIA
Supporting Investigative Journalism...
Center for Investigative Journalism SCOOP Macedonia

Институт за човекови права

MEDIUM



FJALOR/FJALORTH JURIDIK PËR KORRUPSIONIN DHE GAZETARINË INVESTIGATIVE

Ky publikim është përpiluar me mbështetje financiare të Bashkimit Evropian.

Autorë:
Tatijana Temellkoska
dhe Bardhyl Zaimi

Përktheu:
Agim Mustafai

Dizajni dhe përpunimi teknik:
KONTURA DOO

Tirazhi:
200

Botues:
Qendra për Zhvillimin e Medieve
të Bashkësive MEDIUM

Vendi dhe viti i botimit:
Gostivar, 2018

Ky publikim është përpiluar me mbështetje financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e Qendrës për Zhvillimin e Mediave të Bashkësive - MEDIUM dhe në asnjë mënyrë nuk i shpreh qëndrimet e Bashkimit Europian.

HYRJE

Fjalorthi juridik është përpunuar në kuadër të projektit "Së bashku në luftën kundër korrupsionit", i implementuar nga Qendra për Gazetari Hulumtuese SCOOP Maqedoni, në bashkëpunim me organizatat partnere Instituti për të Drejtat e Njeriut nga Shkupi dhe Qendra për Zhvillim të Medieve të Bashkësive MEDIUM.

Projekti "Së bashku në luftën kundër korrupsionit" është i financuar nga Delegacioni i Bashkimit Evropian, përmes Programit IPA – Instrumenti për shoqëri civile dhe mediat 2016-2017.

Fjalorthi juridik, para së gjithash është i dedikuar për gazetarët, redaktorët dhe punëtorët mediatik që marrin pjesë në krijimin e përmbajtjeve gazetareske dhe storieve hulumtuese, qëllimi i të cilave është zvogëlimi i aktiviteteve korruptive. Gazetarët në punën e tyre permanente, sidomos në fushën e gazetarisë investigative, po përballen me më shumë norma juridike të cilat duhet të shpjegohen më tej për publikun e gjerë. Duke pasur parasysh se gazetari pothuajse gjithmonë punon nën presion të kohës, procesi i përdorimit dhe i shpjegimit të termave juridike reflektohet si problematik me gjithë kompleksitetin e vet, e që nënkupton shumë ligje, procedura, definicione gjatë përpunimit të storieve investigative.

Për ta lehtësuar punën e gazetarëve, sidomos te storiet që lidhen me aktivitete korruptive, Qendra për Zhvillimin e Mediave të Bashkësive MEDIUM, në kuadër të projektit "Së bashku në luftën kundër korrupsionit" përpiloi një fjalorth për gazetarinë investigative i cili përfshin më shumë terma dhe shprehje juridike, të cilat përdoren më shpesh gjatë kësaj pune specifike të gazetarëve.

Përgatitja e fjalorthit u realizua nëpërmjet një procesi gjithëpërfshirës të shqyrtimit të ligjeve, doracakëve, hulumtimeve, storieve që lidhen me aktivitetet korruptive dhe llojeve të tjera të dokumenteve që ishin të domosdoshme për strukturimin e gjithë korpusit të termave juridike. Termat janë të definuara në mënyrë profesionale për të mundësuar njohjen më të lehtë të kuptimit të tyre autentik, që rrjedh nga korniza e përgjithshme e ligjeve dhe diskursit juridik.

Gjithashtu, ky proces i definimit dhe shpjegimit u bazua në përpunimin e përkufizimeve të kuptueshme që janë në përputhje me kornizën diskursive gazetareske dhe jruridike ligjore. I gjithë procesi i krijimit të një fjalorthi nënkupton edhe më shumë shqyrtime komparative, e gjithë kjo me qëllim që në mënyrë kreative të përmbushet koncepti për një fjalorth të përdorshëm juridik për gazetarët.

Fjalorthi juridik për korrupsionin për gazetarinë hulumtuese përmban 139 definicione për terma dhe fraza juridike nga legjislacioni maqedonas me të cilin gazetarët ballafaqohen në ngjarjet e përditshme të përcjelljes së ngjarjeve apo raportimit. Njëherit, fjalorthi do të jetë një instrument i mirë për tu shërbyer gazetarëve në punën e tyre edhe në procesin e hulumtimit të aktiviteteve korrupitive. Fjalorthi do të luajë rolin e një instrumenti për të afruar termat juridikë më afër fellës gazetareske për t'i kuptuar më lehët dhe për përdorimin e tyre në produksionin e raportimit investigativ dhe storieve nga sfera e anti-korrupsionit.

FJALORTHI JURIDIK PËR KORRUPSIONIN PËR GAZETARINË INVESTIGATIVE

Regjistri i dispozitave dhe literaturës së shfrytëzuar

- Kodi penal (KP)- tekst i konsoliduar
- Komentimi i Kodit penal, botimi i dytë i ndryshuar – akademik Vllado Kambovski (2011, Matica)
- Ligji për procedurë penale
- Ligji për parandalimin e korrupsionit
- Ligji për parandalimin e konfliktit të interesave
- Ligji për qasje të lirë deri tek informatat me karakter publik
- Ligji për denoncuesit
- Ligji për lobim
- Ligji për financim të partive politike
- Ligji për prokurime publike
- Ligji për përgjegjësi qytetare për fyerje dhe shpifje
- Ligji për nëpunësit publikë
- Ligji për mbrojtje të të dhënave personale
- Ligji për mbrojtje të të dhënave të klasifikuara
- Ligji për gjykatat
- Ligji për prokurorinë publike
- Ligji për kontestet administrative
- Publiciteti në procedurën e kundërvajtjes, Udhërrëfyes për gazetarët nëpër procedurën penale, Sashe Dameski, dr.Jovan Ilievski dhe Zoran Dimitrieski (2014, Misioni i OSBE-së)
- Doracaku për parandalimin e korrupsionit në vetëqeverisjen lokale –Fondacioni Konrad Adenauer, Ministria e shoqërisë informatike dhe administratës dhe Shoqata Maqedonase e Juristëve të Rinj

- Doracaku për gazetari investigative dhe qasje deri tek informatat, Sashe Dimovski dhe Nenad Mirçeski – Instituti i për të Drejtat e Njeriut dhe Qendra për Menaxhim me Ndryshimet (2016)
- Raporti për vlerësim të korrupsionit në Maqedoni, Emina Nuredinovska, Borjan Gjuzelov dhe Misha Popoviq – Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar (2016)
- Raportet e GRECO-s
- Raportet e Transparency International

Lista e shkurtesave

KSHPK	Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit
KEDN	Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut
LPP	Ligji për procedurë penale
PP	Prokuroria publike
VP	Vepër penale
KP	Kodi penal
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MPH	Masa të posaçme hetimore

Abolimi

Abolimi është një akt me të cilin jepet lirim nga ndjekja penale. Mund të jetë pjesë e amnistisë e që bie nën juridiksionin e Kuvendit si shtëpi ligjvënëse dhe pastaj jepet në formë të ligjit për persona të pacaktuar individualisht. Gjithashtu, abolimi mund të jepet edhe si pjesë e faljes, e që bie në kompetencë të kreut të shtetit dhe u referohet personave të caktuar individualisht. Abolimi është pengesë absolute procedurale, që do të thotë se kundër kryerësit apo kryerësve të veprave të përfshirë me aktin e abonimit, nuk mund të ndërmerret asnjë veprim në procedurën penale. Në qoftë se abolimi është dhënë pasi që të ketë filluar procedura, atëherë procedura ndërpritet me ditën e hyrjes në fuqi të ligjit për abolim ose aktvendimin për falje nga ana e presidentit të shteti.

Aktgjykim i shkallës së dytë

Aktgjykim të shkallës së dytë sjell Gjykata e apelit. Duke vepruar lidhur me ankesën dhe përgjigjen ndaj ankesës, gjykata e apelit respektivisht gjykata e shkallës së dytë vendos: 1) ta hedhë poshtë ankesën si të vonuar dhe të palejuar kur ajo është deponuar pas skadimit të afatit dhe nga ana e personave që nuk kanë të drejtën e ankimit, 2) ta refuzojë ankimin si të pabazuar dhe ta vërtetojë aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, 3) ta shfuqizojë aktgjykimin dhe lëndën ta dërgojë për rigjykim dhe vendimmarrje të sërishme, dhe 4) ta ndryshojë aktgjykimin e sjellë nga gjykata e shkallës së parë. Me këtë rast, gjykata e shkallës së dytë e shqyrton aktgjykimin në pjesën që kontestohet me ankesë. Në qoftë se ankesa është deklaruar vetëm në favor të të akuzuarit, gjykata e apelit nuk mund ta ndryshojë aktgjykimin kundër të padituri në raport me kualifikimin juridik të veprës dhe sanksionit penal. Gjykata e shkallës së dytë vendos në seancë të këshillit të përbërë

prej tre gjyqtarëve ose në seancë publike, në rastet kur ajo vlerëson se nevojitet të shpalosen prova të reja për shkak të gjendjes së konstatuar faktike të gabuar dhe jo të plotë.

Aktgjykimi ekzekutiv
Aktgjykimi i plotfuqishëm bëhet i ekzekutueshëm kur është dorëzuar palëve dhe kur nuk ka pengesa ligjore për ekzekutimin. Nëse nuk është paraqitur ankesë ose palët kanë hequr dorë nga ankesa, vendimi është i ekzekutueshëm me skadimin e afatit për ankesë (15 ose 8 ditë), respektivisht nga dita e heqjes dorë ose anulimit të ankesës së shpallur.

Aktgjykimi i plotfuqishëm
Aktgjykimi dhe aktvendimi bëhen të plotfuqishme kur më nuk mund të kundërshtohem me mjet të rregullt juridik - ankesë ose kur nuk lejohet ankesa.

Aktgjykimi, llojet
Në pajtim me parimin e ligjshmërisë, gjykimi në lidhje me përgjegjësinë penale të një personi të caktuar mund të sjellë gjykata kompetente në procedurë të përcaktuar me ligj. Aktgjykimi mund t'i referohet vetëm personit që është i akuzuar dhe vetëm veprës penale që është lëndë e akuzës. Gjykata aktvendimin e sjell në bazë të bindjes së lirë gjyqësore, me ç'rast është e obliguar që me ndërgjegje ta vlerësojë çdo provë veç e veç dhe në lidhje me të gjitha provat tjera së bashku, në atë mënyrë duke formuar konkluzion dhe bindje për ekzistimin e fakteve relevante për rastin. Ekzistojnë tri lloje themelore të aktgjykimeve: 1) aktgjykimi refuzues – aktgjykim me të cilin refuzohet akuza për shkak të moskompetencës së gjykatës ose pengesave të tjera procesore, përfshirë edhe kur i akuzuari për të njëjtën vepër tashmë është i dënuar plotfuqishëm, i liruar nga akuza ose procedura kundër tij

është ndërprerë me aktvendim të plotfuqishëm, kur me akt të amnistisë ose faljes është liruar nga ndjekja penale ose në qoftë se ndjekja penale nuk mund të ndërmerret për shkak të vjetërimit, ose kur ekzistojnë rrethana të tjera që e përjashtojnë ndjekjen penale; 2) aktgjykimi lirues - me të cilin i akuzuari lirohet nga akuza dhe shpallet se nuk është fajtor; 3) aktgjykimi dënues – me të cilin i akuzuari shpallet fajtor dhe përcaktuar përgjegjësia e tij penale për një vepër të caktuar. Gjithashtu, në varësi nga veprimi, aktgjykimi mund të jetë aktgjykimi i shkallës së parë, i plotfuqishëm dhe ekzekutues (shih më shumë për secilin prej tyre).

Amnistia

Amnistia është një akt me të cilin shteti, i personifikuar në parlamentin apo kreun e shtetit, si subjekt i vetëm i ndjekjes penale dhe ndëshkimit mund ta heqë ose ta zbusë dënimin e shqiptuar dhe pasojat e tij juridike në rrethana të caktuara saktësisht. Me amnisti jepet 1) lirim nga ndjekja penale, 2) lirim i plotë ose i pjesshëm nga ekzekutimi i dënimit, 3) zëvendësohet dënimi i shqiptuar me një dënim më të lehtë, 4) përcaktohet fshirja e dënimit ose 5) shfuqizohen pasojat e caktuara juridike të gjykimit. Amnisti jep Kuvendi i Republikës së Maqedonisë dhe kjo bëhet me një ligj që ka të bëjë me një person të paspecifikuar individualisht. Kuvendi nuk mund të japë amnisti të papërcaktuar, që do të thotë se ligji me të cilin jepet amnisti duhet gjithmonë t'i referohet një kategorie të caktuar të veprave, të një kategorie të caktuar të shkelësve apo të personave të gjykuar ose të dënimeve të caktuara (për shembull, të zvogëlohet për një të tretën dënimi me burg për të gjithë personat e dënuar, apo të gjitha dënimet e shqiptuara deri në tre vjet zëvendësohen me gjobë). Abolimi i cili do të thotë lirim nga ndjekja penale (shih më shumë) mund të jetë pjesë e amnistisë.

Ankandi elektronik

Ankandi elektronik është një proces i përsëritshëm i limitimit negativ që realizohet me vlerësimi të plotë fillestar të ofertave, ku ofertuesit kanë mundësi, kryekëput me shfrytëzimin e mjeteve elektronike, të rishikojnë çmimet e dhëna, kështu që renditja bëhet automatikisht me ndihmën e mjeteve elektronike. Në prokurimet publike, organi kontraktues mund të shfrytëzojë ankand elektronik:

- si fazë e fundit në procedurë të hapur, procedurë e kufizuar, procedurë me kërkesë për grumbullimin e ofertave apo ose në procedurë me negocim me shpallje paraprake në rastet sipas nenit 89 paragrafi (1) alineja 1, të Ligjit për prokurime publike, para dhënies së kontratës për prokurime publike dhe vetëm nëse specifikimet teknike janë saktësisht të përcaktuara, ose
- gjatë rihapjes së grumbullimit të ofertave nga operatorët ekonomikë që janë palë në marrëveshjen kornizë, në përputhje me nenet 119 paragrafi (5) dhe 120 të Ligjit për prokurime publike.

Organi kontraktues e cek shfrytëzimin e ankandit elektronik në shpalljen për dhënien e kontratës për prokurim publik dhe në dokumentacionin e tenderit.

Ankesa – mjet i rregullt juridik

Ankesa është i vetmi mjet i rregullt juridik e cila u qëndron në dispozicion prokurorëve publikë, paditësit privat, të akuzuarit, mbrojtësit të tij apo përfaqësuesit ligjor dhe të dëmtuarit në procedurë penale. Ajo ngrihet kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe ka efekt suspensiv që nënkupton se e shtyn zbatimin e tij. Ankesa gjithashtu ka edhe efekt devolutiv, që do të thotë se mbi të nuk vendos gjykata e cila e ka sjellë aktgjykimin, por një gjykatë më e lartë drejtpërdrejt. Të drejtë ankese kanë të dyja palët në procedurën penale: prokurori publik dhe paditësi privat nga njëra anë dhe i padituri dhe mbrojtësi i tij

nga ana tjetër. Afati për deklarimin e ankesës në procedurë të rregullt është 15 ditë, ndërsa në procedurën e shkurtuar kjo periudhë është 8 ditë. Një kopje e ankesës i dorëzohet gjithmonë palës së kundërt, e cila ka të drejtë të përgjigjet në afat prej 8 ditëve. Me ankesën, aktgjykimi mund të kundërshtohet për shkak të bazave të parashikuara me ligj, të cilat përfshijnë: 1) gjendje faktike të gabuar ose jo të plotë, 2) shkelje esenciale të procedurës penale, 3) shkelje të Kodit Penal dhe 4) për shkak të vendimit për sanksionin penal, për konfiskim të dobisë pronësore, shpenzimet e procedurës, për kërkesën pronësore-juridike dhe vendimin për publikimin e aktgjykimit në media.

Autorizimet diskrete

Diskrecioni nënkupton lirinë për të vendosur se si të veprohet në lidhje me një vendim konkret zyrtar. Përdorimi i përhapur i autorizimeve diskrecionare krijon rrezik të lartë për konflikte të interesit. Është e pashmangshme që një person zyrtar të shfrytëzojë diskrecion në ushtrimin e autorizimeve dhe detyrave të tij publike. Por, kjo do të thotë se me këtë rast patjetër të veprojë në kuadër të autorizimeve dhe detyrave të përcaktuara ligjërisht dhe në përputhje me parimet për parandalimin dhe zvogëlimin e konflikteve të interesit.

B

Bazat e dyshimit – dyshim i bazuar

Edhe pse kushtet janë të ngjashme, megjithatë me to bëhet gradacioni i dyshimit dhe materialit të provave me të cilin mbështeten pretendimet për vepër të kryer penale kundër një personi të caktuar. Gjegjësisht, bazat e dyshimit janë njohuri të cilat bazuar në dijen dhe përvojën kriminalistike, mund të vlerësohen si dëshmi për një vepër të kryer penale. Nga ana tjetër, dyshimi i bazuar është një shkallë më e lartë dyshimi, e cila bazohet në provat e mbledhura

që çojnë drejt konkluzionit se një person i caktuar ka kryer vepër penale.

Bashkëpjesëmarrës
Bashkëpunëtor është personi i cili mund të jetë bashkëkryerës i një vepre penale të caktuar, për çka është përgjegjës penalisht brenda kufijve të synimit ose neglizhencës së tij, nxitës ose ndihmues në kryerjen e veprës penale.

Burimi i informatave
Ligji për parandalimin e korrupsionit parashikon mbrojtjen e burimit të informacioneve të gazetarëve dhe parasheh se askush nuk mundet që nga gazetari i cili ka publikuar informata për një akt korrupsioni, të kërkojë ta zbulojë burimin e informacionit, përveçse në procedurë para gjyqit.

D

Dënimet, llojet e dënimeve
Dënimi është një nga llojet e sanksioneve penale dhe ka karakter retributiv dhe preventiv. Kjo do të thotë se ka karakter e një përgjigjeje të drejtë (dënimi) për vepër të kryer, ndërsa njëkohësisht ka ndikim në risocializimin e kryerësit dhe largimin e tij nga kryerja e mëtejshme e veprave penale (preventivë speciale), si dhe ndikimin edukativ mbi të personat tjerë për të mos kryer vepra penale (preventivë e përgjithshme). Në KP janë paraparë llojet e mëposhtme të dënimeve: 1) Dënim me burg si dënimi më i rëndë me të cilin preket në të drejtën dhe lirinë e të dënuarit. Dënimi me burg nuk mund të jetë më i shkurtër se 30 ditë ose më i gjatë se 20 vjet. Ekzistojnë vepra të rënda për të cilat është parashikuar dënim i përjetshëm, i cili mund të shqiptohet si dënim i afatgjatë me prej 40 vitesh. 2) Ndëshkim me para me të cilën kufizohet e drejta e pronës. Ajo shqiptohet në gjoba ditore, duke filluar nga 5

deri në 360 ditë gjoba ditore. Vlera më e ulët e gjobës ditore është 1 Euro, kurse më e madhja 5000 Euro kundërvlerë në denarë. 3) Ndalimi për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës shqiptohet kur kundërvajtësi e ka abuzuar profesionin e tij, veprimtarinë ose detyrën në lidhje me fitimin, disponimin dhe menaxhimin e pronës dhe ekziston rreziku se veprimtarinë e tillë do ta keqpërdorë për kryerjen e sërishme të ndonjë vepre penale. Ky ndalim mund të shqiptohet edhe ndaj personit zyrtar, personit përgjegjës në një subjekt juridik ose personit që kryen punë me interes publik. Ndalimi mund të jetë në kohëzgjatje deri në dhjetë vjet, 4) Ndalimi i drejtimit të automjetit motorik, 5) Dëbimi i një të huaji nga vendi, dhe 6) Ndalimi për të ndjekur ndeshje sportive. Më tej, ndëshkimet ndahen në dy grupe: kryesore dhe dytësore. Ndëshkimet kryesore janë burgu dhe gjoba. Burgu mund të shqiptohet kryekëput si dënim kryesor. Së bashku me dënimin kryesor, gjykata mund të shqiptojë një ose më shumë dënime dytësore.

Dëmi jomaterial

Dëmi jomaterial është dëmi i shkaktuar nga shkelja e të drejtave personale të një personi fizik ose juridik për një dhimbje fizike, dhimbjeve shpirtërore dhe për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, shëmtimit ose frikës së shkaktuar.

Dëshmitari

Dëshmitari është person që ka njohuri të drejtpërdrejtë për faktet dhe rrethanat që lidhen me veprën penale dhe autorin e saj. Dëshmitarët merren në pyetje veç e veç. Si rregull, dëshmitari përgjigjet i jep me gojë. Para se të fillojë marrja në pyetje, dëshmitari paralajmërohet se është i obligjuar të tregojë të vërtetën dhe se nuk guxon të heshtë asgjë, ndërsa më pas paralajmërohet se dhënia e deklaratës së rreme paraqet vepër penale. Dëshmitari

paralajmërohet se nuk është i obliguar tu përgjigjet pyetjeve të caktuara që janë paraparë me ligj.

Denoncuesit

Denoncuesit (kallëzuesit) kanë një rol të veçantë dhe të rëndësishëm, si në qasjen represive ashtu edhe në atë preventive në luftën kundër korrupsionit. Abuzimet në institucione, pavarësisht nëse ato janë publike apo private, ndonjëherë zbulohen vetëm përmes zbardhjes së informacioneve. Për të siguruar informacione të tilla, përdoret termi "denoncues". Denoncimi mund të jetë një pjesë e rëndësishme e zbulimit të abuzimeve. Shpeshherë ky informacion e ndërton bazën për hetim fillestar administrativ, intern ose esktern, ndërsa mund të rezultojë me hetim penal.

Denocuesit gëzojnë mbrojtje ligjore nga çdo lloj shkelje e të drejtave, veprimeve të dëmshme respektivisht rreziqeve nga veprimet e dëmshme për shkak të zbulimit raportimit të bërë.

Me Ligjin për mbrojtjen e denoncuesve rregullohet denoncimi i mbrojtur, të drejtat e denoncuesve, si dhe veprimi dhe obligimet e institucioneve, respektivisht personave juridikë në lidhje me raportimin e mbrojtur dhe sigurin e mbrojtjes së denoncuesve. Kategoritë e personave të cilët në përputhje me këtë ligj mund të paraqiten në cilësinë e denoncuesve janë: personi i cili është në marrëdhënie pune me kohë të pacaktuar ose të caktuar në institucionin, përkatësisht në subjektin juridik për ku raporton; kandidati për punësim, kandidati për vullnetar ose praktikant në institucion, respektivisht në subjektin juridik për ku raporton; personi i cili është ose ka qenë vullnetar apo praktikant në institucion, respektivisht në subjektin juridik për ku raporton; personi i cili në çfarëdo baze është ose ka qenë i angazhuar për të kryer punë nga institucioni, respektivisht në subjektin juridik për ku raporton; person

i cili në çfarëdo baze është ose ka qenë në marrëdhënie afariste ose në një marrëdhënie tjetër bashkëpunimi me institucionin, respektivisht në subjektin juridik për ku raporton; personi që shfrytëzon ose ka shfrytëzuar shërbime në institucionin, respektivisht në subjektin juridik në sektorin publik dhe privat për ku raporton.

Dokumenti
Dokument, në përputhje me Ligjin për qasje të lirë deri tek informatat me karakter publik, është çdo shënim informacioni pa marrë parasysh formën fizike apo karakteristikat e tij, tekst i shkruar ose i shtypur, hartat, skemat, fotografitë, vizatimet, skicat, materialet e punës, si dhe pajisje portative për përpunimin automatik të të dhënave me memorie të instaluar ose të lëvizshme për ruajtjen e të dhënave në formë digjitale.

Donacioni
Donacioni është ndihmë vullnetare dhe e pakushtëzuar në para, mallra dhe shërbime që nuk krijon përfitim të drejtpërdrejtë për ofruesin, as obligim për tu kthyer nga marrësi i donacionit. Donacioni mund të jepet për qëllime me interesit publik ose për të mbështetur aktivitetet e marrësit. Lënda e donacionit patjetër të jetë në përputhje me veprimtarinë e marrësit të donacionit. Lëndë e donacionit nuk mund të jenë të mirat dhe shërbimet qarkullimi i të cilave është i ndaluar me ligj.

E drejta autoriale
E drejta autoriale është e drejtë unike dhe e pandashme nga vepra autoriale, që përmban autorizime personale-juridike, autorizime ekskluzive pronësore-juridike dhe autorizime të tjera të autorit.
Ekspertiza dhe eksperti

Ekspertiza paraqet një nga mjetet dëshmuese që përcaktohet kur për përdëftim ose vlerësim të ndonjë fakti të rëndësishëm, duhet të sigurohet gjetje ose mendim nga një person që ka njohuri të nevojshme profesionale. Ekspertizën, sipas rregullës, e kryejnë ekspertë të regjistruar në regjistrin e ekspertëve. Ekspertiza përcaktohet me urdhër me shkrim, të cilin gjatë procedurës paraprake e miraton prokurori publik, ndërsa në seancën kryesore, një urdhër të tillë sjell gjykata. Në këtë kontekst, eksperti ose këshilltari teknik është person profesional nga regjistri i ekspertëve gjyqësorë të cilin palët e angazhojnë kur kanë nevojë për ndihmë profesionale në një fushë të caktuar gjatë procedurës. Të drejtë të barabartë për të propozuar ekspertizë, kanë të dyja palët në procedurë – paditësi i autorizuar dhe i padituri.

Ekspropriimi

Ekspropriimi (shpronësimi) është instituti ligjor i llojit të vet me anë të të cilit shteti (pushteti publik), nëpërmjet kapjes autoritare të të drejtave pronësore të subjekteve të caktuara, ua merr ose ua kufizon këto të drejta në favor të vetin ose në favor të ndonjë subjekti tjetër. Subjekt shpronësimit mund të jetë vetëm pasuria e patundshme në pronësi të qytetarëve, personave civilë-juridikë, organizatave shoqërore politike, organizatave shoqërore dhe shoqatave të qytetarëve.

Ekzekutimi i sanksioneve

Gjykatë kompetente për ekzekutimin e sanksioneve është gjykata themelore sipas vendbanimit, përkatësisht vendqëndrimit të personit të dënuar. Nëse gjykata e cila ka marrë vendim në shkallë të parë me të cilin është shqiptuar sanksioni nuk është përgjegjëse për ekzekutimin e tij, deri te gjykata e cila është përgjegjëse për ekzekutimin (ose ndonjë organ tjetër - në varësi të llojit të sanksionit)

do të dorëzojë kopje të vendimit me vërtetim se i njëjti është i ekzekutueshëm. Në të gjitha gjykatat themelore konstatohet emërohet gjykatës për ekzekutimin e sanksioneve. Gjyqtari për ekzekutimin e sanksioneve, i mbron të drejtat e të personave të dënuar, bën mbikëqyrje të ligjshmërisë në procedurën për ekzekutimin e sanksioneve dhe siguron barazi për personat e dënuar para ligjit.

F

Falja

Falja është institucion i cili ka të njëjtin efekt si edhe amnistia. Ndryshe nga amnistia (shih më shumë), falja paraqet një akt të mëshirës të kreut të shtetit si përfaqësues i pushtetit ekzekutiv. Falja jepet në bazë të vendimit të justifikuar të Presidentit të Republikës së Maqedonisë dhe u referohet personave të caktuar individualisht. Me faljen jepet: 1) lirimi nga ndjekja penale, 2) lirimi i plotë ose i pjesshëm nga ekzekutimi i dënimit, 3) dënimi i shqiptuar zëvendësohet me dënim më të butë ose me masë alternative, 4) përcaktohet fshirja e gjykimit ose 5) anulohet ose shkurtohet kohëzgjatja e pasojave të caktuara juridike të gjykimit ose dënimit. Procedura e faljes është e rregulluar me Ligjin për falje, ku dallon falja sipas kërkesës së të dënuarit dhe sipas detyrës zyrtaret, kur Presidenti do të vlerësojë se ekzistojnë shkaqe të arsyeshme. Abolimi, që do të thotë përjashtim nga ndjekja penale, mund të jetë pjesë e faljes (shih më shumë abolimi).

Financimi i partive politike

Financimi i partive politike është publik dhe transparent, me inspektim të plotë nga ana e qytetarëve dhe organit kompetent për kontroll mbi punën materiale-financiare. Partitë politike kanë të drejtën e pronësisë së lokaleve afariste, pajisjeve, materialeve për zyrë, automjeteve transportuese dhe pronës tjetër të luajtshme të nevojshme

për arritjen e objektivave dhe realizimin e aktiviteteve të përcaktuara me statutin e partisë dhe me ligj. Partitë politike financohen nga burime publike dhe private të financimit. Burimet publike të financimit të partive politike janë mjetet financiare të siguruara nga buxheti i Republikës së Maqedonisë dhe buxhetet e komunave dhe të Qytetit të Shkupit. Burimet private të financimit të partive politike janë: pagesa e anëtarësisë, donacionet, dhuratat, kontributet, sponsorizimet, legatet, shitjet e materialeve promovuese dhe materialeve propaganduese dhe të hyrat hyra vetjake në përputhje me ligjin për partitë politike. Partitë politike nuk mund të kryejnë veprimtari ekonomike. Partitë politike nuk mund të krijojnë lloje të tjera të të ardhurave, përveç sa vijon: kamata mbi depozitin e deponuar në bankë, qiraja ose dhënia me qira e ambienteve të partisë, të ardhurat nga shitja e publikimeve të shtypura, audo-vizuale dhe digjitale dhe materialeve të tjera propaganduese dhe të ardhurat nga shitja e biletave për prezencë në manifestime të organizuara për qëllime partiake. Partitë politike nuk mund të financohen nga qeveritë, institucionet ndërkombëtare, organet shtetërore dhe lokale, institucionet publike, ndërmarrjet, fondet publike dhe subjekteve tjera juridike që disponojnë me kapital shtetëror, shoqata të qytetarëve, bashkësive fetare dhe grupeve religjioze. Partitë politike janë të detyruara të mbajnë kontabilitet për punën financiare-materiale të partisë. Mbikëqyrjen mbi punën financiare-materiale të punës së partive politike e kryejnë Ministria e Financave dhe Enti Shtetëror për Revizion.

Fleta anketuese për gjendjen pasurore

Obligimi për dorëzimin e fletës anketuese për gjendjen pasurore është parashikuar në Ligjin për parandalimin e korrupsionit. Fleta anketuese përmban një përshkrim të detajuar të pronës së paluajtshme, sendeve të luajtshme

me vlerë më të madhe, letrave me vlerë, debiteve dhe kredite, si dhe pasuri të tjera në pronësi të personit i cili ka obligim ligjor ta paraqesë pasurinë, ose pasurinë në pronësi të familjarëve të tij, me ç'rast theksohet baza e fitimit të pronës së deklaruar. Gjithashtu, ligji kërkon që të deponohet deklaratë e noterizuar për heqje dorë nga mbrojtja bankare në lidhje me të gjitha llogaritë në bankat vendase dhe të huaja. Gjobë për kundërvajtje do t'i shqiptohet personit i cili nuk do të parashtrojë fletëparaqitje të detyrueshme, respektivisht njoftim për ndryshim të gjendjes pasurore.

Fleta anketuese për gjendjen pasurore – obligim për paraqitje

Detyrim ligjor për parashtrim të fletës anketuese dhe raportimit të gjendjes pasurore kanë personat në vijim: funksionari i zgjedhur apo i emëruar, personi zyrtar dhe personi përgjegjës në ndërmarrje publike apo subjekt tjetër juridik që disponon me kapital shtetëror, si dhe personi zyrtar me rastin e punësimit në organet shtetërore, në administratën e njësive të vetëqeverisjes lokale. Ky detyrim duhet të përmbushet në afat prej 30 ditëve nga data e zgjedhjes, emërimit ose punësimit. Gjithashtu, këta persona kanë për obligim të plotësojnë dhe të dorëzojnë fletë anketuese në afat prej 30 ditëve pas ndërprerjes së funksionit të tyre ose punësimit. KSHPK e monitoron përmbushjen e këtij obligimi dhe mund të fillojë procedurë për të hetuar gjendjen pasurore nëse ekzistojnë dyshime se gjatë kryerjes së punëve me interes publik, pasuria e personit është rritur në mënyrë disproporcionale në aspektin e të ardhurave të tija të rregullta ose të ardhurave të anëtarëve të familjes së tij.

Fjala hyrëse

Shqyrtimi kryesor fillon me fjalët hyrëse të palëve. Në fjalën hyrëse, secila palë shkurtimisht e prezanton pikëpamjen e vet për rastin, përkatësisht ngjarjen penale-juridike dhe

e publikon materialin e provave që do të shpaloset gjatë procedurës së provave. Fjalën e parë hyrëse e mban prokurori, pasuar nga fjala hyrëse e mbrojtësit dhe e të padituri. Kështu që, i padituri nuk është i detyruar të mbajë fjalim hyrës.

Fjalët përfundimtare
Fjalët përfundimtare pasojnë në fund të seancës kryesore, pas përfundimit të procedurës së provave. Gjegjësisht, pasi që gjykata ta përfundojë procedurën e provave, i fton paditësin, të dëmtuarin, avokatin mbrojtës dhe të padituri që të japin fjalën e tyre përfundimtare.

G

Gjyqi i apelit
Në territorin e Republikës së Maqedonisë ekzistojnë katër gjykata të apelit ose gjykata të shkallës së dytë me seli në Manastir, Gostivar, Shkup dhe Shtip. Ato janë kompetente: të vendosin mbi ankesat kundër vendimeve të gjykatave themelore nga zona e tyre; të vendosin për konflikt të kompetencave ndërmjet gjykatave të shkallës së parë në zonën e tyre; të vendosin për përjashtimin e kryetarit të një gjykate themelore dhe delegimin në një gjykatë tjetër kompetente vendore dhe çështje të tjera të përcaktuara me ligj. Gjykatat e apelit veprojnë në këshille prej pesë gjyqtarësh (për vepra penale për të cilat është paraparë dënim me burg prej 15 vitesh ose burgim i përjetshëm) ose tre gjyqtarë (për vepra penale për të cilat është paraparë një dënim më i butë). Kur gjykon në shkallë të dytë të shqyrtimit, këshilli përbëhet nga dy gjyqtarë dhe tre gjyqtarë porotë. Seancat e këshillave gjyqësore, me përjashtim të seancave publike, mbahen pa praninë e publikut.

Gjyqi Suprem i Republikës së Maqedonisë

Gjyqi Suprem, si gjykata më e lartë në vend, vendos: 1) në shkallën e tretë dhe të fundit mbi ankesat kundër vendimeve të gjykatave të apelit; 2) në shkallë të dytë kundër vendimeve të këshillave të saj në rastet e përcaktuara me ligj; 3) mbi mjetet e jashtëzakonshme juridike kundër vendimeve të plotfuqishme të gjykatave dhe vendimeve të këshillave të veta kur kjo është përcaktuar me ligj; 4) për konfliktin e kompetencave midis gjykatave themelore nga territoret e gjykatave të ndryshme të apelit, ndërmjet gjykatave të apelit dhe ndërmjet Gjykatës Administrative dhe një gjykate tjetër dhe vendos për bartjen e kompetencës vendore te këto gjykata; 5) vendos mbi kërkesën për shkelje të së drejtës së gjykimit brenda një afati të arsyeshëm në procedurë para gjykatave të vendit dhe 6) kryen aktivitete të tjera të përcaktuara me ligj. Gjykata Supreme vepron në këshillat e përbërë nga pesë gjyqtarë. Në seancë të përgjithshme (të gjithë gjyqtarët), Gjykata Supreme vendos mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër vendimit të marrë nga këshilli i tij. Gjithashtu, në seancë të përgjithshme, Gjykata Supreme cakton qëndrime parimore mbi zbatimin e ligjeve dhe shqyrton çështje të ndryshme që lidhen me punën e gjykatave dhe gjyqtarëve.

Gjyqet themelore, kompetenca

Në Republikën e Maqedonisë ekzistojnë 27 gjykata themelore apo të shkallës së parë që merren me materie penale dhe civile. Për territorin e Qytetit të Shkupit, Gjykata Themelore Shkupi I Shkup është gjykatë penale me juridiksion themelor dhe të zgjeruar, ndërsa Gjykata Themelore Shkupi II Shkup është gjykatë civile. Gjykatat themelore vendosin në shkallë të parë: 1) për të gjitha llojet e kundërvajtjeve, përveç kundërvajtjeve të cilat me ligj janë vënë në kompetencë të një organi tjetër;

2) për vepra penale për të cilat me ligj si dënim kryesor është përcaktuar dënimi me burg deri në pesë vjet, përveç për vepra penale që janë në kompetencë të një gjykate tjetër; 3) për vepra penale për të cilat me një ligj të posaçëm është përcaktuar kompetenca e gjykatës me kompetencë themelore; 4) zbatojnë hetim ose veprime hetimore për veprat penale brenda juridiksionit të vet; 5) për ankesa dhe kundërshtime ndaj procedurave për të cilat janë kompetente këto gjykata. Përveç kësaj, gjykatat themelore me juridiksion të zgjeruar, vendosin edhe për vepra penale për të cilat parashihet dënimi me burg mbi pesë vjet dhe për veprat penale dhe kundërvajtje të kryera nga fëmijët; bëjnë hetime dhe veprime hetimore për vepra penale brenda juridiksionit të vet; veprojnë për rastet e ekstradimit; vendos mbi ankesat dhe kundërshtimet ndaj procedurave për të cilat janë kompetent, si dhe vendosin për procedurat për asistencë juridike ndërkombëtare.

Gjykimi korrekt – e drejta për gjykim korrekt

E drejta për gjykim të drejtë është një nga të drejtat themelore të njeriut që janë të garantuara me Kushtetutë, LPP dhe me disa konventa ndërkombëtare, në veçanti Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ). Sipas nenit 6 të KEDNJ-së, "çdokush gëzon të drejtën për gjykim të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm pra një gjykate të pavarur dhe të paanshme e caktuar me ligj, të shqyrtohen dhe përcaktohen të drejtat dhe obligimet e tija qytetare ose bazueshmëria e çfarëdo akuze penale kundër tij." Kjo në dukje dispozitë e thjeshtë fsheh të drejtën jashtëzakonisht të rëndësishme dhe kompleks. E drejta për gjykim të drejtë ka përmbajtje të gjerë dhe mbulon një gamë të të drejtave, duke përfshirë: 1) të drejtat në procedurë para gjykimit, ku bëjnë pjesë e drejtën për liri, e drejta për njoftim të personit të privuar nga liria, e drejta për avokat, e drejta për të komunikuar me

botën e jashtme, e drejta që personi të sillet para gjyqit, e drejta e shqyrtimit të bazueshmërisë së privimit nga liria, si dhe e drejta gjatë privimit nga lira; 2) të drejtat lidhur me gjykimin e drejtë dhe publik brenda një kohe të arsyeshme nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e përcaktuar me ligj dhe në procedurë të rregulluar me ligj; 3) të drejtat gjatë gjykimit, ku bëjnë pjesë e drejta për mbrojtje materiale dhe formale, e drejta për të marrë pjesë në gjykim, e drejta për të shqyrtuar dëshmitarët e akuzës dhe mbrojtjes, e drejta e ankesës, e drejta për të marrë kohë të mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes dhe të tjera të drejta gjatë marrjes në pyetje; 4) prezumimi i pafajësisë, 5) ndalimi i zbatimit prapaveprues të kodit penal, 6) ndalimi i dënimit për të njëjtën vepër dy herë (ne bis in idem), 7) dhe e drejta për barazi para gjyqit.

I dëmtuari

Krahas viktimës së drejtpërdrejtë nga vepra penale, është i dëmtuar një person tjetër emri personal ose e drejta pasurore e të cilit është cenuar ose rrezikuar me vepër penale dhe që merr pjesë në procedurën penale duke iu bashkangjitur ndjekjes penale ose për shkak të realizimit të kërkesës pronësore –juridike.

I dyshuari

I dyshuari është person kundër të cilit udhëhiqet procedurë paraprake, respektivisht procedurë parahetimore dhe hetimore.

I gjykuari

I gjykuar është personi për të cilin me vendim të plotfuqishëm është konstatuar se është penalisht përgjegjës për vepër të caktuar penale. Sanksionet e shqiptuara për veprën e kryer penale ekzekutohen kur vendimi për të cilin është shqiptuar

sanksioni, do të bëhet e plotfuqishme dhe kur nuk ekzistojnë pengesa ligjore për ekzekutimin e tyre (shih më shumë).

Integriteti
Integriteti, ka më shumë domethënie, mes të cilave ai do të thotë "rezistencë ndaj korrupsionit". Ekzistojnë dy lloje kryesore të integritetit që janë të ndërlidhura ngushtë ndërmjet veti, ndërsa kjo është integriteti institucional dhe personal. Integriteti institucional nënkupton sistem të të gjitha politikave, standardeve dhe procedurave të vendosura në një organizatë/institucion që rrisin rezistencën e saj ndaj korrupsionit dhe e zvogëlojnë rrezikun e sjelljes korruptive nga ana e të punësuarve. Nga ana tjetër, integriteti personal shënon posedimin e njohurive dhe shkathtësive, kapacitet personal etik, përkushtimin për respektimin e rregullave dhe procedurave të vendosura dhe gjithmonë të punohet në favor të interesit publik, të shmanget konflikti i interesit dhe krijimi i kushteve negative dhe ambientit në mjedisin e punës dhe atë privat.

Informatat me karakter publik
dhe qasja deri te këto informata
Me Ligjin për qasje të lirë deri tek informatat me karakter publik sigurohet publiciteti dhe hapshmëria në punën e poseduesve të informacionit me karakter publik dhe procedurën për qasje deri te këto informacione të gjithë personave juridikë dhe fizikë.

Interesi publik
Interesi publik është një interes më i gjerë shoqëror për të mirën e përgjithshme dhe përparimin e të gjithë qytetarëve nën kushte të barabarta, në kuptim material dhe jomaterial, i cili mund të rrezikohet duke shkaktuar dëme të natyrës materiale dhe jomateriale për shkak të veprimit nga pozita e konfliktit të interesit privat me atë publik.

Informatat e klasifikuara
Në përputhje me Ligjin për informata të klasifikuara, informacionet mund të klasifikohet si: interne, konfidenciale, rigoroze konfidenciale dhe sekret shtetëror. Informatat e klasifikuara kanë rëndësi të madhe në hetimin dhe zbulimin e akteve të korrupsionit. Gazetarët shpesh përballen me sfidën e sigurimit të qasjes në këto të dhëna për shkak të faktit se poseduesit e tyre refuzojnë t'i ndajnë këto informacione, pa bërë testin krahasues midis interesit publik dhe atij privat. Gjithsesi, në qoftë se gazetarit ose cilitdo person i lejohet të bëjë këqyrje në lëndët gjyqësore, është e nevojshme që paraprakisht të mënjanohen të gjitha informatat e klasifikuara dhe të anonimizohen dosjet e lëndës varësisht nga faza e procedurës. Ndërkaq, nëpunësit të cilët kanë ardhur në kontakt me informacionet e klasifikuara, janë të obliguar ta ruajnë sekretin, ashtu siç përcakton ligji. Publikimi i informatave të klasifikuar të shkallës më të lartë, rigoroze konfidencial ose sekretit shtetëror përbën bazë për përgjegjësi penale të gazetarëve.

Interesi privat
Interesi privat nënkupton interes material ose jo-material të personit zyrtar i cili mund të ndikojë në vendimmarrjen e tij gjatë ushtrimit të autorizimeve dhe detyrave të tija publike. Kjo nënkupton një interes që sjell përfitime personale për personin zyrtar që nuk duhet t'i përkasë. Duke vepruar nga pozita e konfliktit të interesave, u shkaktohet dëm të personave të tjerë dhe shoqërisë në tërësi. Interesi privat do të thotë jo vetëm interes financiar, përfitim ose shmangie e humbjes, por edhe përfitimet jomateriale, kundërshërbime, përparësi, beneficione, privilegje.

Incizimi në gjyq dhe ndërtesën gjyqësore
Incizimi vizual (video) dhe i zërit (audio), raportimin dhe fotografimi në procedurën penale dhe shfaqjen publike

(riproduktimi) i incizimit bëhet pas miratimit nga ana e kryetarit të Gjykatës Supreme, ndërsa pas marrjes paraprake të mendimit të kryetarit të këshillit të gjyqtarëve, në mënyrën e parashikuar me ligj. Krahas miratimit të këtillë, këshilli gjykues mund të vendosë të mos incizohet pjesë të caktuara të seancës kryesore. Po ashtu, kryetari i Gjyqit Suprem, në bazë të kërkesës së parashtruar me shkrim, jep leje për incizim ose fotografim në një lëndë konkrete penale. Jashtë gjykimit, incizimi dhe fotografimi në ndërtesën e gjykatës mund të bëhet me miratimin e kryetarit të gjykatës i cili e menaxhon ndërtesën. Kërkesa për incizim duhet të dorëzohet në afat prej pesë ditësh para seancës së caktuar. Me rastin e dhënies së lejes për fotografim dhe incizim, duhet t'i kushtohet vëmendje interesit të publikut, interesave të procedurës, privatësisë dhe sigurisë së pjesëmarrësve në procedurë.

I padituri

I padituri është person kundër të cilit është vërtetuar aktakuza, është parashtruar propozim aktpadi, është parashtruar kërkesa për aplikimin e masës së sigurisë, është ngritur padi private ose është parashtruar propozim për lëshimin e urdhrit penal. Shprehja i paditur përdoret edhe si emër i përgjithshëm për të dyshuarin, të padituriin dhe të dënuarin.

Kallëzimi penal

K

Parashtrimi i padisë penale është obligim qytetar dhe obligim i të gjitha organeve shtetërore, ndërmarrjeve publike dhe institucioneve, sidomos për vepra penale që ndiqen sipas detyrës zyrtare. Fletëparaqitja parashtrohet pranë prokurorit publik kompetent, me shkrim ose gojarisht, me telefon, me mjete elektronike ose duke përdorur mjete dhe mënyra të tjera teknike. Nëse fletëparaqitja dorëzohet

nëpërmjet pajisjes elektronike, sigurohet regjistrim elektronik i saj dhe hartohet shënim zyrtar. Nëse ajo parashtrohet gojarisht, denoncuesi do të paralajmërohet për pasojat e raportimit të rremë. Për denoncimin me gojë do të përpilohet procesverbal, dhe nëse padia penale është shpallur përmes telefonit, do të përpilohet shënim zyrtar. Nëse kallëzimi penal është parashtruar në polici, gjykatë ose në prokurorinë publike kompetente, ata do ta pranojnë raportin dhe menjëherë do ta dorëzojnë atë te prokurori publik kompetent. Prokurori publik, në afat prej muajsh nga marrja e kallëzimit penal, duhet të vendosë mbi kallëzimin dhe për këtë ta informojë parashkruesin e kallëzimit penal dhe prokurorin më të lartë publik.

Kërkuesi i informatës
Në përputhje me Ligjin për qasje të lirë deri tek Informatat, kërkues i informacionit është çdo person juridik ose person fizik i cili kërkon informacione me karakter publik në mënyrën dhe kushtet e përcaktuara me ligj, pa mos qenë me këtë rast i diskriminuar në çfarëdo qoftë baze.

Këqyrja
Këqyrja (inspektimi) parqet një nga mjetet e provave që shpesh përdoret. Këqyrjen e ndërmerr prokurori publik, ndërsa me autorizimin e tij edhe policia gjyqësore, kur për shkak të konstatimit apo sqarimit të ndonjë fakti të rëndësishëm në procedurë, nevojitet vëzhgimi i drejtpërdrejtë. Gjatë inspektimit, mund të jenë të pranishëm i dyshuari, mbrojtësi dhe i dëmtuari. Mungesa e tyre nuk e shtyn ndërmarrjen e inspektimit. Për këqyrjen përpilohet procesverbal i cili bashkëngjitet në aktet e lëndës.

Keqpërdorimi i të dhënave
Një funksionar i zgjedhur ose i emëruar, person zyrtar ose person përgjegjës në një ndërmarrje publike nuk guxon

t'i përdorë informacionet të cilat i ka në dispozicion të tij për të bërë përfitim për vete ose për tjetërkënd. Obligimi nga paragrafi 1 të nenit 31 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit mbetet në afat prej tre vitesh nga dita e ndërprerjes së funksionit, përveç nëse me ligj është përcaktuar ndryshe. Personi nuk guxon të mbajë në konfidencë të dhëna të cilat sipas këtij ligji ose të ndonjë ligjit tjetër patjetër të publikohen ose të kërkojë qasje deri tek të dhënat për të cilat ai e di se nuk është i autorizuar t'i marrë ose të sillet pa ndërgjegje ndaj mbajtjes së të dhënave që paraqesin sekret.

Komisioni anketues

Komisionin anketues e formon Kuvendi i Republikës së Maqedonisë. Njëzet anëtarë të Kuvendit mund të parashtrojnë pyetje për përcaktim të përgjegjësisë për korrupsion ku janë involvuar funksionarë të zgjedhur apo të emëruar, persona zyrtarë, persona përgjegjës në ndërmarrjet publike dhe subjektet e tjera juridike të cilat disponojnë me kapital shtetëror. Kryetari i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë është i obliguar që çështjen ta vë në rend dite të seancës së radhës së Kuvendit të Republikës së Maqedonisë ku pas debatit paraprak, deputetët të cilët e kanë ngritur çështjen i elaborojnë shkeljet e Ligjit për parandalimin e korrupsionit apo dispozitat e Kodit Penal dhe formohet një komision hetimor. Komisioni është i autorizuar të kërkojë nga çdo organ, ndërmarrje publike, institucion publik ose nga ndonjë subjekt tjetër juridik që disponon me kapital shtetëror ose nga një parti politike e cila ka deputet, respektivisht deputetët e vet në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë t'ia paraqesë të gjitha dokumentet e nevojshme dhe materiale të tjera të rëndësishme për sqarimin e rastit dhe të ftojë në seancë dëgjimore cilindo funksionar të zgjedhur apo emëruar, person zyrtar, person

përgjegjës në ndërmarrje publike apo në ndonjë subjekti tjetër juridik ose personin përgjegjës të partisë politike. Vendimet që kanë të bëjnë me ndërmarrjen e veprimeve të caktuara në shqyrtimin e rastit, do të merren me shumicë votash. Seancat e komisionit janë publike. Komisioni është i obliguar të paraqesë në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë një raport në afat prej 60 ditëve nga formimi i tij. Nëse nuk arrihen qëndrime të harmonizuara, raporti i përmban të gjitha qëndrimet e anëtarëve të komisionit. Kryetari i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë është i obliguar që raportin e komisionit ta vë në shqyrtim në seancën e parë të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë nga dita e miratimit të tij. Raporti shqyrtohet në seancë publike të Kuvendit.

Kontrata për prokurim publik

Kontrata për prokurim publik është kontratë me interes financiar, e cila i përfshin edhe kontratat sektoriale, e lidhur me shkrim ndërmjet një ose më shumë organeve kontraktuese nga njëra anë dhe një ose më shumë operatorëve ekonomikë në anën tjetër, lëndë e së cilës është realizimi i punëve, furnizimi me mallra ose ofrimi i shërbimeve në përputhje me ligjin. Kontratë sektoriale është një kontratë për prokurim publik që ndahet në funksion të kryerjes së një ose më shumë aktiviteteve nga neni 176 paragrafi (1) i Ligjit për prokurime publike. Kontrata për prokurim publik realizohet ndërmjet organeve kontraktuese. Organet kontraktuese janë: organet shtetërore, organet e njësive të vetëqeverisjes lokale dhe të Qytetit të Shkupit; subjektet juridike të themeluara për një qëllim specifik për të plotësuar nevojat me interes publik që nuk kanë karakter industrial ose komercial; ndërmarrjet publike, shoqëritë aksionare dhe kompanitë me përgjegjësi të kufizuar. Ka lloje të ndryshme të kontratave për prokurime publike: kontrata për

prokurim publik mund të jetë kontratë për prokurim publik për mallra, kontratë për prokurim publik për shërbime dhe kontratë për prokurim publik të punëve, lënda e kontratës për prokurim publik mund të formohet në disa pjesë të veçanta identike, me ç'rast për çdo pjesë mund të lidhet kontratë e veçantë, ofertuesi mund të paraqesë ofertë për një, për disa ose për të gjitha pjesët, me ç'rast oferta patjetër të përfshijë të paktën një pjesë të tërë, ofertuesi duhet në ofertën e vet të cek nëse ajo i referohet gjithë lëndës së kontratës ose vetëm pjesëve të caktuara dhe nëse ofertuesi paraqet ofertë për dy ose më shumë pjesë, të njëjtën e parashtron në mënyrën që do të mundësojë që secila pjesë të vlerësohet veç e veç.
Operator ekonomik është secili person fizik ose juridik ose grup i personave të tillë të cilët në treg ofrojnë mallra, shërbime ose punë.

Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit - kompetencat

Ndërmjet kompetencave më të rëndësishme ligjore të KSHPK numërohen kompetencat që kanë të bëjnë me preventivën dhe represionin e korrupsionit në nivel strategjik, edukimin dhe forcimin e vetëdijes publike, ndjekjen e pasurive të funksionarëve, personave zyrtarë dhe përgjegjës, dorëzimin e iniciativave për ngritjen e procedurës para organeve kompetente, duke përfshirë edhe procedurën penale, si dhe të vepruarit në rast të konfliktit të interesave. Më konkretisht, sipas Ligjit për parandalimin e korrupsionit, KSHPK sjell program shtetëror për parandalim dhe represion të korrupsionit dhe Planit aksional për realizimin e tij; jep mendime mbi propozim ligjet me rëndësi për parandalimin e korrupsionit; ngre iniciativë para organeve kompetente për kontrollin e punës financiare-materiale të partive politike, sindikatës dhe shoqatave dhe fondacioneve të qytetarëve; inicion

ngritjen e procedurës para organeve kompetente për shkarkim, shpërndarje, ndërrim apo zbatim të masave të tjera të përgjegjshmërisë së funksionarëve të zgjedhur apo të emëruar, personat zyrtarë ose personat përgjegjës në ndërmarrjet publike dhe subjektet tjera juridike të cilët disponojnë me kapital shtetëror; ngre iniciativë për fillimin e procedurës për ndjekjen penale të funksionarëve të zgjedhur apo të emëruar, personat zyrtarë ose personat përgjegjës në ndërmarrjet publike, institucionet publike dhe subjektet tjera juridike që disponojnë me kapital shtetëror; vepron në rastet e konfliktit të interesit publik dhe personal, të përcaktuar me ligj; e evidenton dhe e ndjek gjendjen pasurore dhe ndryshimin e gjendjes pasurore të funksionarëve të zgjedhur dhe të emëruar dhe të personave përgjegjës në ndërmarrjet publike dhe subjektet tjera juridike që disponojnë me kapital shtetëror; përgatit raporte vjetore për punën e vet dhe ia dorëzon Presidentit të Republikës, Kuvendit, Qeverisë dhe Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë dhe i publikon në mjetet për informim publik; si dhe ndërmerr aktivitete në fushën e edukimit të organeve kompetente për zbulimin dhe ndjekjen e korrupsionit dhe llojet e tjera të kriminalitetit dhe bashkëpunon me organet vendore dhe organizatat ndërkombëtare. Në qoftë se ka nevojë, për të sqaruar çështje të caktuara, KSHPK mund ta ftojë edhe personin kundër të cilit udhëhiqet procedurë, si dhe persona të tjerë të cilët mund të kontribuojnë në drejtim të qartësimit fakteve për një rast të caktuar. KSHPK mundet që prej cilitdo personi zyrtar të kërkojë të dhëna dhe njoftime për gjendjen e ti pasurore ose gjendej n pasurore të anëtarëve të familjes së tij, për ndryshimet në gjendjen pasurore, për veprimtarinë e atij personi apo të ndonjë anëtari të familjes së tij, të ardhurat e gjeneruara ose të tjera të dhëna që janë të rëndësishme për parandalimin e korrupsionit. Gjithashtu mund të kërkojë të dhëna

dhe njoftime nga ndonjë organ kompetent ose person përgjegjës tek një subjekt juridik i cili është i detyruar të veprojë pa u vonuar brenda 15 ditëve. Në qoftë se personi përgjegjës në organin kompetent apo personi përgjegjës i subjektit juridik nuk vepron mbi kërkesën, KSHPK mund të fillojë iniciativë për ngritjen e procedurës përpara organit kompetent për konstatimin e përgjegjësisë së tij. Gjithashtu KSHPK miraton edhe Program shtetëror me Plan aksional për parandalimin dhe reduktimin e dukurisë së konfliktit të interesave, jep mendime për propozim-ligjet me rëndësi për parandalimin e konfliktit të interesave, i verifikon deklaratat për interesa, shqyrton rastet e konfliktit të interesit publik dhe privat dhe e informon publikun për rastet mbi të cilat ka vepruar.

Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit - statusi dhe përbërja

KSHPK është autonome dhe e pavarur në ushtrimin e kompetencave të veta ligjore. Ka cilësinë e personit juridik. Përbëhet nga shtatë anëtarë të emëruar nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë për një mandat pesëvjeçar, me të drejtë riemërimi. Nga radhët e anëtarëve të emëruar zgjidhet kryetari i KSHPK-së për një periudhë njëvjeçare. Anëtarët e KSHPK-së kanë statusin e personi të emëruar dhe janë të obliguar që funksionin e tyre ta ushtrojnë profesionalisht, ndërsa për punën e vet përgjigjen para Kuvendit të Republikës së Maqedonisë.

Komisioni për mbrojtje të së drejtës për qasje të lirë deri tek informatat me karakter publik

Komisioni për mbrojtjen e të drejtës për qasje të lirë deri tek informacionet me karakter publik është i pavarur në punën e vet dhe në marren e vendimeve në kuadër të kompetencave të veta të përcaktuara me ligj. Komisioni përbëhet nga pesë anëtarë, njëri prej të cilëve është kryetar,

ndërsa tjetri zëvendës i kryetarit. Mandati i anëtarëve është pesë vjet me të drejtë rizgjedhjeje. Kryetari dhe zëvendësi i kryetarit funksionin e vet e kryejnë në mënyrë profesionale. Komisioni i kryen punët në vijim: vendos mbi ankesat kundër aktvendim dhe konkluzionit me të cilin poseduesi i informacionit e ka refuzuar kërkesën për qasje në informacion kërkuesve të informacionit; kujdeset për zbatimin e dispozitave të këtij ligji; përgatit dhe publikon listë të poseduesve të informacioneve; jep mendime mbi propozim-ligjet që rregullojnë qasjen e lirë deri tek informatat; ndërmerr aktivitete në planin e edukimit të poseduesit të informacionit për tu mundësuar kërkuesve qasje të lirë në informatat të cilat ata i posedojnë; bashkëpunon me poseduesit e informacioneve në lidhje me realizimin e së drejtës për qasje deri tek informatat; jep propozime për mjetet e nevojshme për punën e Komisionit gjatë përgatitjes së buxhetit të Republikës së Maqedonisë; sjell Rregulloren për punën e vet; përgatit raport vjetor për punën e vet dhe ia dorëzon atë Kuvendit të Republikës së Maqedonisë; bën punë të bashkëpunimit ndërkombëtar në lidhje me zbatimin e obligimeve ndërkombëtare të Republikës së Maqedonisë, pjesëmarrje në zbatimin e projekteve të organizatave ndërkombëtare dhe bashkëpunon me organet e vendeve dhe institucioneve të tjera në fushën e qasjes së lirë deri tek informatat me karakter publik; miraton Statutin, si dhe aktet e tjera që rregullojnë punën dhe organizimin e Komisionit dhe kryen detyra të tjera të përcaktuara me këtë dhe me ligje tjera.

Konfiskimi i pronës dhe dobisë pronësore

Konfiskimi i pronës dhe dobisë pasurore të fituar me vepër penale paraqet masë ndëshkuese-juridike të posaçme, e cila nuk është e lidhur me ndëshkimin e kryerësit. Ajo bazohet në parimin themelor se askush nuk duhet të mbajë dobinë pasurore direkte ose indirekte të fituar me

vepër penale. Sipas Kodit Penal, rregullat për konfiskim të personave fizikë dhe juridikë janë identikë. Konfiskimi bëhet ndaj kryerësit, anëtarëve të familjes së tij në qoftë se nuk kanë dhënë kompensim adekuat, si dhe ndaj palëve të treta. Në qoftë se konfiskimi nuk është i mundur, atëherë prej kryerësit do të konfiskohet çdo pasuri që përputhet me vlerën e përfitimit të bërë. Prona e konfiskuar do t'i kthehet palës së dëmtuar, dhe nëse nuk ka të tillë, ajo bëhet pronë e shtetit. E vetmja specifikë shfaqet atëherë kur prej personit juridik nuk mund të konfiskohet prona apo të dobia pasurore, për shkak se ajo ka pushuar së ekzistuari. Në rast të tillë përgjegjësia shuhet, por pasardhësi/it ligjo ose kur të tillë nuk ekzistojnë, themeluesi/ it ose aksionari/ aksionarët në mënyrë solidare marrin përsipër të paguajnë një sasi monetare që i përgjigjet përfitimit të realizuar. Është e rëndësishme të theksohet se konfiskimi mund të shqiptohet edhe atëherë kur kryerësi nuk është fajtor për pjesën (fëmijë, nuk ka aftësi të mjaftueshme ose ekzistojnë pengesa procesore për veprim). Prona e konfiskuar, në bazë të marrëveshjes ndërkombëtare, mund të kthehet në një shtet tjetër që është shumë e rëndësishme për rastet e veprave të krimit të organizuar dhe korrupsionit me element ndërkombëtar.

Konfiskimi i pronës dhe dobisë pronësore – e zgjeruar

Kjo masë e posaçme ndëshkuese-juridike është futur në legjislacionin tonë penal në pajtim me Konventën e OKB-së kundër krimit të organizuar dhe Konventën e OKB-së kundër korrupsionit. Ky lloj i konfiskimit zbatohet ndaj kryerësit të veprës së kryer brenda një shoqërie kriminale me të cilën është realizuar përfitim pasuror dhe për të cilën është përcaktuar dënim me burg prej më shumë se katër vjet dhe vepra të tjera, siç është pastrimi i parave. Mund të konfiskohet prona që është fituar para gjykimit, varësisht nga rrethanat e rastit, por jo më gjatë se pesë vjet.

Koncesioni
Koncesion do të thotë ndarje e të drejtës për shfrytëzim të të mirave me interes të përgjithshëm për shtetin, realizimin e ndërtimit me interes publik ose kryerjen e shërbimeve publike, me ngarkim të koncesionarit që të ndërtojë dhe/ose të menaxhojë, të shfrytëzojë ose mirëmbajë objektin e koncesionit, me pagesë ose pa pagesë nga ana e koncedentit.

Korrupsioni
Korrupsioni, në kuptimin më të gjerë të fjalës, nënkupton shfrytëzimin e pozicionit zyrtar, pozitën e autoritetit ose fuqisë për qëllime private. Konventa e OKB-së kundër korrupsionit nuk përmban definicion, por i liston veprat penale që lidhen me korrupsionin. Transparency International e përkufizon korrupsionin si një abuzim me fuqinë e besuar për përfitim privat. Në pajtim me Ligjin për parandalimin e korrupsionit, nënkuptohet shfrytëzim i një funksioni, autorizimi publik, detyre zyrtare dhe pozite për të arritur ndonjë përfitim për vete ose për një person tjetër. Për më tepër, ligji parashikon që askush nuk guxon ushtrimin e funksionit, autorizimit publik, detyrës dhe pozitës zyrtare, si dhe punët me interes publik, t'i shfrytëzojë për realizimin e qëllimeve personale. Në këtë kontekst, korrupsioni minon sundimin e së drejtës, legjitimitetin e pushtetit, vlerat demokratike dhe realizimin e barabartë të të drejtave dhe lirive të qytetarëve dhe shkatërron prosperitetin ekonomik, mirëqenien dhe mirëbesimin e qytetarëve dhe publikut në institucionet shtetërore. Ekzistojnë kualifikime nga më të ndryshmet të llojeve dhe formave të korrupsionit. Kështu, në varësi nga përmasa e korrupsionit, dallojnë korrupsionit i madh/i trashë dhe i vogël/i imët. Korrupsioni i madh nënkupton keqpërdorim të pozicioneve të larta të pushtetit në interes të një grupi të vogël individësh të privilegjuar, ndërsa në

dëm të një numri të madh të qytetarëve, në të cilën mënyrë shkaktohen shkelje serioze dhe sistematike të sistemit institucional, juridik, ekonomik dhe social të shoqërisë. Ky lloj i korrupsionit është i vështirë për t'u zbuluar dhe shpesh mbetet i pandëshkuar. Në anën tjetër, korrupsioni i imët nënkupton keqpërdorimin e fuqisë së besuar të bartësve të autorizimeve publike dhe zyrtare në punën e tyre të përditshme dhe komunikimin me qytetarët e thjeshtë në procedurat në të cilat ata i realizojnë të drejtat dhe nevojat e tyre themelore, si për shembull në sferën e arsimit, shëndetësisë, lëshimit të dokumenteve personale dhe të tjera. Ky korrupsion i imët zakonisht pranohet si një "fenomen normal dhe mënyrë e funksionimit të administratës". Ka edhe kategorizime të ndryshme të korrupsionit në varësi nga sfera në të cilën shfaqet.

Korrupsioni në politikë

Në kontekst të përgjithshëm, me korrupsion politik nënkuptojmë keqpërdorimin apo manipulimin me politikat, procedurat dhe rregullat gjatë dhënies së mjeteve financiare dhe financimin e atyre që marrin vendime politike, të cilët në atë mënyrë e ruajnë pozitën e tyre të fuqisë dhe pasurinë e fituar në mënyrë të paligjshme. Prandaj gjatë zgjedhjeve presidenciale, parlamentare apo lokale ekziston një moratorium apo ndalim në përdorimin e mjeteve buxhetore. Kjo gjithashtu përfshin ndalim për të filluar ndërtimin e objekteve të infrastrukturës me mjete buxhetore, si për shembull rrugë, ujësjellës, largpërçues dhe të ngjashme, si dhe objekteve për veprimtari shoqërore, të tilla si shkollat dhe shtëpitë shëndetësore. Ndalimi vlen edhe kur paraprakisht janë siguruar mjete nga buxheti, respektivisht kur ndërtimi është pjesë e programit që është sjellë në bazë të ligjit në vitin aktual. Gjithashtu, në periudhën para dhe gjatë zgjedhjeve, mjetet buxhetore nuk guxojnë të përdoren për pagesa të jashtëzakonshme

të rrogave, pensioneve, ndihmës sociale dhe pagesa tjera, ndërsa është i ndaluar edhe tjetërsimi i kapitalit shtetëror dhe nënshkrimi i marrëveshjeve kolektive. Në afat prej tre muajsh pas zgjedhjeve, KSHPK dorëzon Kuvendit raport të veçantë për keqpërdorimet e mundshëm të mjeteve buxhetore, i cili publikohet në media. Personat zyrtarë të cilët kanë vepruar në kundërshtim me këto ndalime përgjigjen për kundërvajtje, që do të thotë se do të dënohet me gjobë.

Konfiskimi i sendeve

Sekuestrimi i sendeve, së bashku me konfiskimin e pronës dhe përfitimeve nga prona, përbën një masë të posaçme penale-juridike që nuk lidhet me sanksionin që i shqiptohet kryerësit të veprës. Askush nuk mund t'i mbajë ose t'i përvetësojë sendet që kanë dalë nga kryerja e veprës (produkt i veprës, për shembull paratë e falsifikuara ose të "lara"). Gjithashtu, sekuestrohen edhe sendet që janë përdorur ose janë të dedikura për kryerjen e veprës penale (paratë në rastin e ryshfetit) ndërsa sekuestrohen edhe nga palët e treta nëse janë të rrezikshme për shoqërinë. Me sekuestrimin e këtyre sendeve, ato vendosen jashtë qarkullimit ligjor për shkak të rrezikut të ripërdorimit të tyre për kryerjen e veprës penale, si dhe karakterit të tyre kundërligjor.

Kompetenca gjyqësore e shkallës
së parë për vepra të korrupsionit

Më shpesh veprat penale të korrupsionit bien brenda juridiksionit të Gjyqit Themelor Shkupi 1 – Departament i specializuar gjyqësor që vepron për veprat nga krimi i organizuar dhe korrupsioni, edhe atë territorin e gjithë shtetit. Ky departament është kompetente të gjykojë për: 1) veprat penale të kryera nga një grup i strukturuar prej tre ose më shumë personave, që ekziston një periudhë të

caktuar kohore dhe që vepron me qëllim që të kryejë një ose më shumë vepra penale për të cilat është paraparë dënim me burg prej së paku katër vjet, me qëllim që të fitojë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë dobi financiare ose ndonjë dobi tjetër; 2) vepra penale të kryera nga një grup i strukturuar apo organizatë kriminale në territorin e Republikës së Maqedonisë apo të shteteve të tjera, ose kur vepra penale është përgatitur ose planifikuar në Republikën e Maqedonisë ose në një shtet tjetër; 3) vepra penale shpërdorim i pozitës zyrtare dhe autorizimit nga neni 353, paragrafi 5, marrje ryshfeti me vlerë të konsiderueshme nga nenin 357 dhe ndërmjetësim kundërligjor nga neni 359 të KP të kryera nga një funksionar i zgjedhur ose i emëruar, person zyrtar ose person përgjegjës në një subjekt juridik; dhënie ryshfeti me vlerë më të madhe nga nenit 358, ndikim i paligjshëm mbi dëshmitarët sipas nenit 368-a, larje e parave dhe të ardhurave tjera nga akti i dënueshme me vlerë të konsiderueshme sipas nenit 273, si dhe vepra të tjera penale (...).

Konflikti i interesave

Konflikti i interesave është gjendje e konfliktit ndërmjet autorizimeve dhe detyrave publike me interesi privat të personit zyrtar në të cilin interesi privat ndikon ose mund të ndikojë mbi zbatimin e autorizimeve dhe detyrave të tij publike. Prandaj, konflikti shfaqet si mbikëqyrës, i mundshëm dhe, në fakt, është hyrje në korrupsion. Në të njëjtën kohë, korrupsioni mund të përfshijë konflikt interesash, por të gjitha rastet e konfliktit të interesave nuk janë në të njëjtën kohë raste të korrupsionit.

Kontesti administrativ

Kontesti administrativ është një lloj i veçantë i kontrollit gjyqësor mbi punën e administratës, mbi punën e organeve administrative. Karakteristikë e kontesteve administrative-

juridike, gjithsesi, është ajo se si palë në vetë procedurën paraqitet shteti. Në këtë kuptim, si kontest administrativ duhet të konsiderohet çdo kontest në të cilin një cilësinë e të padituri t paraqitet ndonjë subjekt i punës administrative pa dallim të së drejtës që zbatohet në atë kontest.

Krimi i organizuar

Krimi i organizuar paraqet aktivitete të paligjshme që janë kryer nga një grup i organizuar kriminal që ekziston një periudhë të caktuar kohore me qëllim që të kryejë kriminalitet serioz dhe me qëllim që drejtpërdrejtë ose tërthorazi të krijojë përfitim financiar ose ndonjë dobi tjetër materiale apo fuqi, ndërsa gjatë realizimit të kriminalitetit serioz grupi të shfrytëzojë frikësimin, dhunën, korrupsionin, larjen e parave, kontrollin direkt ose indirekt mbi politikën, autoritetet, mediat dhe ekonominë, aktivitetet afariste dhe shfrytëzim të mjete të tjera për të arritur qëllimet.

Kufizimi i lirisë së të shprehurit dhe mediave

Liria e shprehjes dhe liria e mediave për të shpërndarë informata me interes publik, paraqet një prej të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të cilat garantohen me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Kushtetutën dhe ligjet. Këto liri nuk janë absolute dhe të pakufizuara. Të gëzuarit e këtyre lirive, në të njëjtën kohë, tërheq edhe detyrime dhe përgjegjësi të caktuara. Prandaj realizimi i këtyre lirive mund të reduktohet në formalitete, kushte, kufizimeve ose sanksione, siç është parashikuar me ligj dhe është e domosdoshme në një shoqëri demokratike, ndër të tjera, në interes të mbrojtjes nga kriminaliteti, mbrojtjes së dinjitetit ose të drejtave të të tjerëve, për parandalimin e publikimit të informacioneve konfidenciale ose për mbajtjen e autoritetit dhe pavarësisë së gjyqësorit.

Lobimi, parimet e lobimit

Lobimi është një aktivitet i drejtuar kah pushteti legjislativ dhe ekzekutiv në nivel qendror, si dhe kah pushteti lokal, me qëllim të përcaktimit të interesave në procesin e sjelljes së ligjeve dhe dispozitave tjera. Sipas ligjit për lobimi, lobisti është person fizik i cili bën lobim për një kompensim përkatës me para, i regjistruar për kryerjen e lobimit në pajtim me këtë ligj, ose është i punësuar në një subjekt juridik të regjistruar për kryerjen e lobimit me të cilin ka lidhur kontratë për lobim. Porositës i lobimit është personi i interesuar fizik ose juridik i cili ka interes nga lobimi përpara pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe lokale. Lobimi zbatohet vullnetarisht, në bazë të një kontrate me shkrim ndërmjet lobistit, respektivisht personit juridik tek i cili është i punësuar lobisti dhe porositësi i lobimit, si palë në lobim. Porositësi i lobimit i lëshon lobistit autorizim me të cilin lobisti pprezantohet para organeve tek të cilët lobon. Në marrëveshjen nga paragrafi (1) të nenit 3 të Ligjit për lobim përcaktohen kushtet nën të cilat zbatohet lobimi,në përputhje me këtë ligj, si dhe kompensim për lobim. Lobuesi vepron ndërgjegjshëm dhe përgjegjshëm, në pajtim me këtë ligj dhe në kuadër të marrëveshjes nga neni 3 i këtij ligji. Informacionet të cilat lobisti i ka marrë nga porositësi i lobimit ose vetë ka ardhur deri tek ato, janë konfidenciale, përveç nëse palët lobuese përcaktohen ndryshe në kontratën nga neni 3 të këtij ligji. Lobimi është transparent dhe në çdo kohë porositësi i lobimit, si palë në lobim, ka të drejtë të inspektojë aktivitetet e lobistit, si dhe çështjet që janë me rëndësisë për lobimin.

Llojet e procedurave për ndarjen e kontratave për prokurim publik

Ligji për prokurime publike i parashikon procedurat e mëposhtme të cilat organet kontraktuese mund t'i përdorin për të dhënë kontrata publike për prokurim publik:

- Procedurë e hapur është procedura në të cilën secili operator ekonomik ka të drejtë të dorëzojë ofertë
- Procedurë e kufizuar është procedura në të cilën secili operator ekonomik ka të drejtë të parashtrojë paraqitje për pjesëmarrje, ndërsa vetëm kandidatët e përzgjedhur nga ana e organit kontraktues ftohen të parashtrojnë ofertë.
- Dialogu konkurrues është një procedurë në të cilën secili operator ekonomik ka të drejtë të dorëzojë fletë-paraqitje për pjesëmarrje dhe sipas të cilës organi kontraktues zhvillon dialog me kandidatët e përzgjedhur me qëllim që të përcaktojë një ose më shumë zgjidhje të përshtatshme të cilat do t'i plotësojnë kërkesat e tij dhe në bazë të të cilave kandidatët e përzgjedhur do ta përgatisin ofertën e tyre.
- Procedura me negocim është një procedurë në të cilën organi kontraktues i konsulton kandidatët e përzgjedhur dhe negocion për kushtet e kontratës me një ose më shumë prej tyre. Ekzistojnë dy lloje të procedurës me negocime: procedura me negocim me publikimin e shpalljes dhe procedura me negocim pa publikimin e shpalljes.
- Procedura me kërkesë për grumbullimin e ofertave është një procedurë e thjeshtëzuar për dhënien e kontratës për prokurim publik, e cila zbatohet kur duhet të jepen kontrata vlera e të cilave është deri në 5.000 euro në kundërvlerë në denarë, ose 20.000 euro në kundërvlerë në denarë për mallra dhe shërbime, respektivisht deri në 50.000 euro në kundërvlerë në denarë për punë. Procedura për dhënien e kontratës për prokurim publik fillon me shpalljen në Sistemin elektronik të prokurimeve publike, respektivisht duke dërguar ftesë për dorëzimin e ofertës tek procedura me negocim pa publikim të shpalljes. Sistemi elektronik për prokurime publike është një sistem i vetëm i kompjuterizuar i disponueshëm në internet, i cili përdoret për të mundësuar efikasitet më të madh dhe ekonomizim në fushën e prokurimeve publike.

Masat alternative

Masat alternative, si një lloj i sanksioneve penale, janë kryesisht të natyrës parandaluese. Ato përmbajnë kërcënim me dënim, që është vënë në plan të dytë, si një përforcim i masës së mbikëqyrjes dhe trajtimit të lirisë. Qëllimi i këtyre masave është që ndaj kryerësit të veprës më të lehtë penale të mos aplikohet dënim dhe kur mund të pritet që qëllimi i dënimit do të realizohet vetëm me kërcënim për dënim për kryerësin që do të mbetet në komunitet. Ekzistojnë disa lloje të masave alternative, duke përfshirë: gjykim me kusht, gjykim me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse, ndërprerje me kusht të procedurës penale, punë në komunitet, vërejtje gjyqësore dhe arrest shtëpiak.

Masat e sigurisë

Si një lloj i posaçëm i sanksionit penal, masat e sigurisë janë kryekëput sanksione speciale-preventive. Ato kanë për qëllim t'i eliminojnë kushtet dhe gjendjet që mund të ndikojnë që kryerësi në të ardhmen të mos bëjë vepra penale. Ato shqiptohen në lidhje me një kategori të caktuar personash, si personat imprevedebil me prevedebilitet të reduktuar dhe të varur nga alkooli dhe droga. Së këndejmi, ata kanë karakterin e masave të dhunshme të trajtimit mjekësor dhe përfshijnë trajtimin e detyrueshëm psikiatrik në një institucion apo në liri, trajtimin e detyrueshëm të të varurve nga droga dhe trajtimin mjekësor dhe farmakologjik.

Masat për sigurimin e pranisë së të padituri

Me qëllim të sigurimit të pranisë së të padituri dhe udhëheqjes së papenguar të procedurës penale, shfrytëzohen masat në vijim: 1) ftesa; 2) masa të kujdesit si: ndalimi për braktisjen e vendbanimit të përhershëm ose të përkohshëm, obligim

që i akuzuari të paraqitet herë pas here te një person zyrtar i caktuar ose te organi kompetent, pezullimi i përkohshëm i pasaportës ose ndalesë për lëshim të tij etj; 3) garanci, lartësinë e së cilës e përcakton gjykata dhe paraqet sasi monetare që përcaktohet në përputhje me peshën e veprës penale, rrethanave personale dhe familjare dhe gjendjen pasurore të të akuzuarit, me ç'rast mund ta depozitojë i akuzuari personalisht ose një person tjetër; 4) shoqërimi nga policia; 5) privimi nga liria; 6) mbajtja; 7) paraburgim afatshkurtër; 8) arrest shtëpiak dhe 9) paraburgim (shih më shumë për paraburgimin). Gjatë marrjes së vendimit se cila nga masat e cekura do të zbatohet, gjykata mban llogari që të mos zbatojë një masë më të rëndë nëse synimi i njëjtë mund të arrihet me një masë më të butë. Gjykata ndaj të akuzuarit njëkohësisht mund të përcaktojë më shumë masa, përveç kur do të përcaktojë masë paraburgimi.

Masa të posaçme hetimore

LPP i parashikon veprat në lidhje me të cilat mund të përcaktohen masa të posaçme hetimore (MPH), si dhe llojet dhe kushtet nën të cilat merren masa të këtilla, ndërsa me të cilat faktikisht ndërhyhet në sferën private të kryerësit në dobi të interesit shoqëror publik dhe mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të qytetarëve të tjerë. Masat e posaçme hetimore mund të merren në rastet kur ka shumë gjasa që të sigurohen të dhënat dhe provat e domosdoshme për udhëheqje të suksesshme të procedurës penale, dhe të cilat në një mënyrë tjetër nuk mund të sigurohen. Masa të tilla janë: ndjekja dhe incizimi i telefonit dhe komunikimeve të tjera elektronike në një procedurë të përcaktuar me ligj; ndjekja dhe incizimi në shtëpi, mjedis i rrethuar ose i hapur që i përket asaj shtëpie apo hapësire afariste si private ose në automjet dhe hyrja në këto mjedise për të krijuar kushte për ndjekjen e komunikimeve; mbikëqyrje sekrete dhe incizim i personave dhe sendeve me mjete teknike jashtë shtëpisë ose hapësirës

afariste të përcaktuar si private; këqyrje dhe eksplorim i fshehtë në sistem kompjuterik; dhe eksplorim dhe automatik dhe krahasimin automatik apo të një forme tjetër i të dhënave personale. Këto MPH i përcakton gjyqtari në procedurën paraprake me urdhër me shkrim, në bazë të kërkesës së arsyetuar të prokurorit publik. Krahas kësaj, ekzistojnë MPH të cilat i përcakton prokurori publik me urdhër me shkrim. Ato përfshijnë: këqyrjen në telefon dhe komunikimet e tjera elektronike; grumbullimin e simuluar të sendeve; dhënien dhe marrjen e simuluar të ryshfetit; dërgesën e kontrolluar dhe transportimin e personave dhe sendeve; shfrytëzimin e persona me identitet të fshehur për monitorim dhe mbledhje të informacioneve; hapjen e llogarisë bankare të simuluar; regjistrim i simuluar i subjekteve juridike ose shfrytëzimin e subjekteve ekzistuese juridike për mbledhjen e të dhënave. E përbashkët për të gjitha MPP është se ato mund të përcaktohen edhe ndaj lëndës së veprës penale, kur nuk është i njohur identiteti i kryerësit. MPH mund të përcaktohen kur ka baza për dyshim për vepra penale për të cilat është paraparë dënim me burg prej së paku katër vjet, ndërsa përgatiten, në vijim është ekzekutimi ose janë ekzekutuar nga një grup i organizuar, bandë ose shoqëri tjetër kriminale ose për forma tjera të veprave të rënda penale, duke përfshirë edhe veprat korruptive si keqpërdorimi i pozitës zyrtare dhe autorizimit, abuzimit në shërbim, mashtrim në shërbim, përvetësim i shërbimit, marrje e ryshfet, dhënie e ryshfetit, ndërmjetësim kundërligjor dhe larje parash (shih më hollësisht për secilën VP). MPH i zbaton prokurori kompetent publik ose policia gjyqësore.

Marrja në pyetje e drejtpërdrejtë,
e kryqëzuar dhe plotësuese

Sipas LPP të ri gjatë shpalosjes së argumenteve lejohet marrje në pyetje e drejtpërdrejtë, e kryqëzuar e dëshmitarit apo ekspertit që e kryejnë palët. Marrjen e drejtpërdrejtë

në pyetje e bën pala, respektivisht mbrojtësi të cilin e ka propozuar dëshmitari respektivisht eksperti si dëshmi. Kur pala do të përfundojë me marrjen në pyetje të drejtpërdrejtë të dëshmitarit të vet apo ekspertit, qaset pala kundërshtare që u bën pyetje të kryqëzuara në mënyrë të tërthortë dëshmitarit ose ekspertëve. Kjo do të thotë se marrja e kryqëzuar në pyete është marrje në pyetje e dëshmitarit dhe ekspertit i cili është i propozuar nga pala e kundërt. Marrjen në pyetje plotësuese e kryen përsëri pala e cila e ka propozuar dëshmitarin respektivisht ekspertin dhe pyetjet që parashtrohen gjatë këtij shqyrtimi janë të kufizuara në pyetjet e parashtruara gjatë shqyrtimit të palës kundërshtare. Në pyetjet e kryqëzuara dhe pyetjet shtesë, palëve mund tu ndihmojnë këshilltarët teknikë gjatë parashtrimit të pyetjeve. Pas përfundimit të pyetjeve nga palët, kryetari dhe anëtarët e këshillit mund t'i parashtrojnë pyetje dëshmitarit, përkatësisht ekspertit.

Marrëveshja e prokurorit publik me të dyshuarin

Rënia në ujdi për fajin, si institucion që buron nga e drejta anglo-saksone, është aprovuar në LPP të ri. Në procesin e rënies në ujdi marrin pjesë vetëm prokurori kompetent publik dhe i dyshuari, në prani të avokatit të tij. Ata negociojnë dhe bien dakord për llojin dhe lartësinë e sanksionit penal, pas çka vijon përcaktimi i elementeve të detyrueshëm të projekt-marrëveshjes dhe nënshkrimit të saj. Në këtë proces, pjesëmarrja e gjykatës dhe publikut është plotësisht e përjashtuar. Pasi të nënshkruhet marrëveshja, kyçet gjyqtari i procedurës paraprake i cili bën vlerësimin e saj por publiku gjithashtu është i përjashtuar edhe nga seanca e vlerësimit. Procedura për dakordim konsiderohet e suksesshme kur gjykata e pranon projekt-marrëveshjen dhe sjell aktgjykim. Aktgjykimi ka karakter të vendimit gjyqësor të formës së prerë dhe bëhet e qasshme për publikun. Me ujdinë, lloji dhe lartësia e dënimit duhet

të jenë në suazat e përcaktuara ligjore për veprën konkrete penale, por nuk guxon të shkojë nën kufijtë për zbutjen e dënimit të përcaktuar me KP. Në qoftë se i dyshuari pajtohet, subjekt i rënies në ujdi mund të jetë edhe kërkesa pronësore-juridike e palës së dëmtuar. Mundësia e parë për rënie në ujdi jepet në fazën e hetimit, kurse mundësia e dytë dhe e fundit jepet gjatë vlerësimit ose kontrollit të aktpadisë. Në procedurën për dakordim, i dyshuari patjetër duhet të ketë dhe të zgjedhë mbrojtës, ndërsa nëse ai nuk zgjedh i vendoset mbrojtës sipas detyrës zyrtare.

Mbrojtësi

Çdo person i dyshuar ose i akuzuar për vepër penale ka të drejtën e mbrojtësit gjatë gjithë procedurës penale. I padituri para marrjes së parë në pyetje apo ndonjë veprimi tjetër, doemos të njoftohet se ka të drejtë për avokat të zgjedhur prej tij me të cilët ballë për ballë mund të këshillohet dhe se mbrojtësi mund të marrë pjesë në inspektimin e tij, për shembull, gjatë thirrjes në bisedë informative në polici ose në prokurorinë publike. Mbrojtës mund të jetë vetëm avokati. Për veprat penale për të cilat mund të shqiptohet dënim me burgim prej së paku dhjetë vjetësh, mbrojtësi mund të jetë avokat me përvojë prej së paku pesë vitesh pas dhënies së provimit të jurisprudencës. Të akuzuarit, gjykata do t'i caktojë mbrojtës sipas detyrës zyrtare në rastet kur ligji parashikon mbrojtje të obligueshme me mbrojtës, ndërsa i akuzuari nuk ka zgjedhur apo nuk mund t'ia lejojë vetes një mbrojtës, edhe atë kur: kundër tij është caktuar paraburgim përderisa zgjat paraburgimi; nëse ai akuzohet për vepër penale për të cilën ligji parashikon dënim me burg prej dhjetë vjet ose dënim më të rëndë me burg; gjatë rënies dakord me prokurorin për pranimin e fajit dhe kur ai gjykohet në mungesë.

Mbrojtja e të dhënave personale

Si e dhënë personale konsiderohet çdo informacion që i referohet një personi të identifikuar ose nëpërmjet të cilit mund të identifikohet një person i caktuar fizik, respektivisht nëpërmjet të cilit identiteti i personit mund të përcaktohet drejtpërdrejt ose tërthorazi. Si e dhënë personale sidomos konsiderohet numri i vetëm amë i qytetarit ose një apo më shumë karakteristika specifike për identitetin e tij fizik, mendor, ekonomik, kulturor ose social. Të dhënat personale që zbulojnë identitetin e individit gëzojnë mbrojtje ligjore. Prandaj, ushtrimi profesional i profesionit të gazetarisë imponon respektimin e privatësisë dhe të dhënave personale të personave që kryejnë investigime për veprime korruptive ose për persona të dyshuar apo të akuzuar. Gazetarët duhet që me kujdes të veçantë të veprojnë me gjurmët dhe informacionet eventuale për veprat e kryera penale, duke mbajtur llogari të mos cenohet parimi i prezumimit të pafajësisë dhe integritetit personal i atyre personave. Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale përcakton se cilat të dhëna janë të karakterit personal, duke përfshirë sidomos të dhënat për gjendjen shëndetësore dhe privatësinë e të gjithë personave dhe pjesëmarrësve në procedurën para gjykatave dhe organeve të tjera administrative. Megjithatë, personalitetet publike, duke pasur parasysh funksionet që i ushtrojnë, shumë më tepër gjenden në fokusin e interesit të publikut dhe janë të ekspozuar ndaj kritikave më të mëdha dhe ndërhyrjes në jetën e tyre private sesa qytetarët e tjerë. Ekzistojnë kategori të veçanta të personave siç janë fëmijët, përkatësisht personat nën moshën 18 vjeç të cilët gëzojnë mbrojtje të veçantë dhe për publikimin e të dhënave të tyre personale nevojitet pëlqim prej prindërve apo kujdestarëve. Për ta kërkohet që të përdoren inicialet dhe të sigurohet mbrojtje tjetër e përshtatshme, siç është distorzioni (shtrembërimi) i pamjes dhe zërit në qoftë se incizohen. Në secilin rast konkret, duhet të vlerësohet nëse ekzistojnë

baza legjitime dhe të lejueshme që tregojnë se mbizotëron interesi publik që të publikohet një e dhënë e caktuar, i cili përndryshe paraqet të dhënë personale ose të dhënë nga sfera private e individit. Kur interesi publik është më i madh dhe i justifikuar, mediat duhet të sigurojnë anonimizim adekuat për personat e përfshirë në procedurën hetimore.

Mbrojtja e dëshmitarëve

Mbrojtja e dëshmitarëve, bashkëpunëtorëve të drejtësisë dhe viktimave është e rregulluar me Ligjin për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe LPP (shih më shumë dëshmitar i rrezikuar). Ligji për mbrojtjen e dëshmitarëve aplikohet kur përdëftimi i veprës penale shoqërohet me vështirësi ekstreme, ose nuk mund të kryhet pa prononcimin e personit për të cilin ekziston rrezik se do t'i nënshtrohet frikësimeve, kërcënimeve, hakmarrjes ose rrezikut ndaj jetës, shëndetit, lirisë, integriteti fizik apo pronës më voluminoze, dhe për këto arsye personi nuk pajtohet të dëshmojë. Përveç kësaj, dëshmimi duhet të bëjë me vepra penale kundër shtetit, kundër njerëzimit dhe të drejtës ndërkombëtare, vepra nga sfera e krimit të organizuar dhe vepra për të cilat KP parashikon dënim me burg prej së paku katër vjet. Ligji parashikon që termi person i mbrojtur nënkupton dëshmitar, bashkëpunëtor i drejtësisë, viktimë që paraqitet në cilësinë e dëshmitarit dhe personave të afërt me ta, i cili me vendim të Këshillit për mbrojtjen e dëshmitarëve është përfshirë në Programin për mbrojtje dhe me të cilin Departamenti për Mbrojtjen e Dëshmitarëve pranë MPB-së ka nënshkruar marrëveshje për mbrojtje. Programi për mbrojtjen e dëshmitarëve paraqet një sistem të masave ligjore dhe aktiviteteve të ndërmarra nga ana e Departamentit për mbrojtjen e dëshmitarëve që kanë për qëllim mbrojtjen e jetës, shëndetit, lirisë, integritetit fizik ose pronës më voluminoze të personave të përfshirë në të. Për përfshirje në Program, nevojitet pëlqim me shkrim

nga personi që propozohet të përfshihet, ndërsa për përfshirjen dhe ndërprerjen vendos Këshilli për Mbrojtjen e Dëshmitarëve. Propozim për përfshirje në Programin, deri te Këshilli dorëzon Prokurori publik i Republikës së Maqedonisë dhe Prokurori publik për ndjekjen e veprave penale të lidhura dhe që dalin nga përmbajtja e përgjimit të paligjshëm të komunikimeve. Departamenti për Mbrojtjen e Dëshmitarëve pranë MPB-së mund t'i përcaktojë ato. Ekzistojnë masat mbrojtëse si në vijim: ruajtja e fshehtësisë së identitetit, ofrimi i mbrojtjes personale, ndryshimi i vendbanimit respektivisht vendqëndrimit, ndërsa për masën ndryshimi i identitetit vendos Këshilli. Masa mbrojtëse ndryshimi i identitetit përbëhet nga ndryshimi i pjesshëm ose i plotë i të dhënave personale të personit të mbrojtur, të cilat futen në dokumentet e reja personale dhe të cilat nuk duhet të jenë identike me të dhënat e një personi tjetër. Në zbatimin e kësaj mase mund të ndërmerren aktivitete për të ndryshuar karakteristikat fizike të personit të mbrojtur. Në rrethana të caktuara, zbulimi i identitetit të dëshmitarit të mbrojtur ose bashkëpunëtorit të drejtësisë, mund të çojë deri në pasoja serioze për shëndetin dhe sigurinë e tij, prandaj edhe është parashikuar përgjegjësia penale. Gjegjësisht, Ligji për Mbrojtjen e Dëshmitarëve përcakton që ai i cili do ta zbulojë identitetin e dëshmitarit të mbrojtur do të dënohet me dënim me burg prej të paktën 4 vjetësh. Në rast se shkaktohen pasoja të rënda për shëndetin e dëshmitarit apo pasoja me vdekje, personi që e ka zbuluar identitetin e dëshmitari të mbrojtur, do të dënohet me burgim prej së paku 8 vjet, së paku 15 vjet ose me burgim të përjetshëm.

Mbrojtja e mjeteve për informim publik dhe të gazetarëve
Kur mediat dhe gazetarët punojnë në hulumtimin e korrupsionit ata patjetër të mbrohen nga të gjitha llojet e presioneve, kërcënimeve, frikësimeve, ndikimeve apo

shantazheve. Në këtë kontekst, Ligji për parandalimin e korrupsionit ndalon çdo lloj detyrimi, pengimi ose ndikimi në një mënyrë tjetër mbi mjetet për informim publik të publikojnë ose të mos publikojnë informacione mbi rastet e korrupsionit. Gazetarit i garantohet e drejta për qasje të pakufizuar në të gjitha burimet e informacionit në përputhje me ligjin. Kjo çështje është e rregulluar me Ligjin për qasje të lirë deri tek informatat me karakter publik, ndërsa përjashtimet kanë të bëjnë me informacionet e klasifikuar (shih më shumë). Gjobë për kundërvajtje do t'i shqiptohet atij i cili bën detyrim ose në cilëndo mënyrë pengon që të publikohet të mos publikohet një informacion mbi rastet e korrupsionit, përveç nëse janë realizuar elementet e veprës penale, si dhe ai që e pengon qasjen kah burimet e informacionit.

Mjeti i jashtëzakonshëm juridik

Mjete të jashtëzakonshme juridike janë: 1) përsëritja e procedurës, 2) kërkesa për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit, 3) kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, 4) shqyrtimi i jashtëzakonshëm i aktgjykimit të plotfuqishëm dhe 5) përsëritja e procedurës për shkak të shkeljes të së drejtës së gjykimit brenda një afati të arsyeshëm. Ato ngrihen kundër një aktvendimi të plotfuqishëm dhe, ndryshe nga ankesa, nuk e prolongojnë ekzekutimin e tij. Gjykatë kompetente që vepron dhe vendos mbi mjetet e jashtëzakonshme juridike është Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë. Kërkesë për përsëritje të procedurës mund të parashtrojë secila nga palët dhe kjo do të thotë rikthim i procedurës penale në gjendjen ose stadin e mëparshëm, për shembull kur personi i cili është gjykuar në mungesë, me kërkesë të tij gjykohet përsëri. Procedura në të cilën i padituri është liruar nga aktakuza nuk mund të përsëritet. Kërkesë për përsëritje mund të parashtrohet edhe pasi i gjykuari ta ketë vuajtur dënimin

dhe pavarësisht vjetërsisë, amnistisë ose faljes. Zbutja e jashtëzakonshme e dënimit lejohet në rastin kur pasi që aktgjykimi të bëhet i formës së prerë, do të lindin rrethana të reja, të cilat nuk kanë ekzistuar ose nuk kanë qenë të njohura, ndërsa mund të çojnë deri në një dënim më të butë. Kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë mund të paraqesë vetëm Prokurori publik i Republikës së Maqedonisë, në qoftë se është shkelur ligji për veprimet që nuk mund të hidhen poshtë me mjete të tjera juridike. Kërkesë për shqyrtim të jashtëzakonshëm të aktgjykimit fuqiplotë parashtron personi i dënuar me burg ose me burg për të mitur, në raste saktësisht të përcaktuara të parapara me LPP. Ky mjet juridik nuk mund të ngrihet kundër aktgjykimit të Gjykatës Supreme. LPP i ri parashikoi mjet të ri juridik të përsëritjes së procedurës për shkak të shkeljes të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, ku gjykata i zbaton standardet e përcaktuara në nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe praktikën gjyqësor të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Mjetet dëshmuese

Si mjete dëshmuese në procedurën penale shfrytëzohen: deklarata e të pandehurit, marrja në pyetje e dëshmitarëve të cilët mund të jenë dëshmitarë të akuzës dhe mbrojtjes, këqyrje dhe rikonstruktim, ekspertizë, incizim dhe provë elektronike.

Ndalesa për gëzimin e të drejtave aksionare

Me Ligjin për parandalimin e korrupsionit, një funksionar i zgjedhur ose i emëruar, person zyrtar dhe person përgjegjës në një ndërmarrje publike, institucion publik ose tek ndonjë person tjetër juridik që disponon me kapital shtetëror, nuk mundet që përderisa i zgjat mandati, respektivisht detyra dhe në afat prej tre viteve

pas ndërprerjes së saj, të fitojë mbi cilëndo bazë ose në çfarëdo forme të drejta aksionare tek një person juridik mbi të cilin ai ose organi në të cilin ai punon ose ka punuar, kryen respektivisht ka bërë mbikëqyrje, përveç nëse ato të drejta i fiton nëpërmjet trashëgimit.

Ndalesa e ndikimit për punësim të familjarëve të afërt
Me Ligjin për parandalimin e korrupsionit, një funksionar i zgjedhur apo i emëruar nuk mund të ushtrojë ndikim për punësimin apo avancimin e anëtarit të familjes së tij në organin ku është zgjedhur ose emëruar, ose në ndonjë organ tjetër shtetëror ose ndërmarrje publike, institucion publik apo subjekt tjetër juridik që disponon me kapital shtetëror në të cilin bën mbikëqyrje organi në të cilin funksionari është zgjedhur ose është emëruar. Një funksionar i zgjedhur ose i emëruar, person zyrtar dhe person përgjegjës në një ndërmarrje publike dhe një personit tjetër juridik që disponon me kapital shtetëror, është i obliguar ta informojë Komisionin Shtetëror për çdo zgjedhje, emërim, punësimin apo avancim të anëtarit të familjes së tij në një organ shtetëror, organ të vetëqeverisjes lokale, ndërmarrje publike ose tek ndonjë person tjetër juridik që disponon kapital shtetëror, në afat prej dhjetë ditësh pas zgjedhjes, emërimit, avancimit ose punësimit të kryer.

Ndalesa për keqpërdorim të mediave
Me Ligjin për parandalimin e korrupsionit ndalohet abuzimi me mediat dhe parashihet se askush nuk mund të shfrytëzojë një mjet për informim publik për akuza të rreme të dikujt tjetër për korrupsion. Gjithashtu, çdo person i cili publikon informacione për korruptim të tjetërkujt është i detyruar të respektojë pafajësinë e supozuar dhe parimet e informimit të drejtë, objektiv dhe të paanshëm, si dhe parimet e tjera të përfshira në kodin për etikë profesionale të gazetarëve.

Nepotizmi
Nepotizmi përfaqëson favorizimin e të afërmve ose të miqve gjatë ndarjes së posteve dhe privilegjeve pa mos mbajtur llogari me këtë rast për ekspertizën.

O

Obligimi për paraqitje të gjendjes pasurore
Detyrim ligjor për të raportuar pronën kanë personat e mëposhtëm: funksionari i zgjedhur apo i emëruar funksionar, personi zyrtar dhe personi përgjegjës në ndërmarrje publike apo ndonjë subjekt tjetër juridik me kapital shtetëror, si dhe personi zyrtar me rastin e punësimit në organet shtetërore, në administratën e njësive të vetëqeverisjes lokale. Ky detyrim duhet të kryhet në afat prej 30 ditëve nga data e zgjedhjes, emërimit ose punësimit. Gjithashtu, këta persona kanë obligim të plotësojnë dhe dorëzojnë fletë anketuese brenda 30 ditëve pas përfundimit të funksionit të tyre ose punësimit. KSHPK e monitoron përmbushjen e këtij obligimi dhe mund të fillojë procedurat për të hetuar gjendjen pasurore nëse ekziston dyshimi se gjatë kryerjes së punëve me interes publik, prona e personit është rritur në mënyrë disproporcionale me të ardhurat e tija të rregullt ose të ardhurat e anëtarëve të familjes së tij.

P

Padia, aktpadia
Aktakuzën e përgatit prokurori dhe e parashtron prokurori deri në gjykatën kompetente, pasi që pas përfundimit të procedurës hetimore konstaton se ekzistojnë prova të mjaftueshme prej të cilave pritet aktgjykim dënues. Gjyqtari ose këshilli për shqyrtimin e aktakuzës ia dorëzon aktakuzën të dyshuarit i cili është në liri pa vonesë dhe nëse është në paraburgim brenda 24 orëve nga pranimi i aktakuzës. Nëse kundër të dyshuarit është caktuar

paraburgim, aktakuza i dorëzohet të dyshuarit me rastin e arrestimi të tij, së bashku me aktvendimin për paraburgim. I dyshuari ka të drejtë të parashtrojë kundërshtim me shkrim në afat prej tetë ditëve nga pranimi i aktakuzës. Një kundërshtim të tillë mund të parashtrojë edhe avokati edhe pa autorizimin të prerë nga i dyshuari, por jo kundër vullnetit të tij. Në qoftë se gjykatësi ose këshilli për vlerësim të aktakuzës konstaton se kundërshtimi është në kohë dhe i deklaruar nga një person i autorizuar, i qaset vlerësimit ose kontrollit të bazueshmërisë së aktakuzës (shih më shumë).

Paraburgim

Paraburgimi paraqet masën më të rëndë për sigurimin e pranisë së të akuzuarit dhe mbarëvajtjen e e papenguar të procedurës penale, ngase personi i privohet nga liria dhe me këtë shkelen liritë dhe të drejtat e tija themelore njerëzore. Kundër personit për të cilin ekziston dyshimi se ka kryer një vepër penale, mund të caktohet paraburgim në rastet e mëposhtme: 1) nëse fshihet ose nuk mund të vërtetohet identiteti i tij ose nëse ekzistojnë rrethana të tjera të cilat në mënyrë të qartë çojnë drejt rrezikut për ikje; 2) në qoftë se ekziston frikë e justifikuar se do t'i shkatërrojë gjurmët e veprës ose që do ta pengojë hetimin duke ndikuar mbi dëshmitarët, bashkëpjesëmarrësit ose mbuluesit; 3) nëse ekzistojnë rrethana të cilat e arsyetojnë frikën se i dyshuari do ta përsëri veprën penale, se do ta përfundojë veprën e tentuar penale ose sepse do ta kryejë veprën penale me të cilën kërcënon dhe 4) nëse i pandehuri i ftuar në mënyrë të rregullt shmang ardhjen në seancën kryesore, ose nëse gjykata ka bërë dy përpjekje për ta thirrur në mënyrë të rregullt të pandehurin,ndërsa të gjitha rrethanat tregojnë se i pandehuri padyshim shmang pranimin e thirrjes.

Në të gjitha këto rrethana, paraburgimi është jo i detyrueshëm (fakultativ). Krahas atij fakultativ, ekziston

edhe ai i detyrueshëm (obligativ) kur gjyqi është i detyruar të caktojë paraburgimin në rastet kur do të shqiptojë aktgjykim me të cilin i akuzuari gjykohet me dënim me burg prej 5 vjet ose më shumë. Para ngritjes së aktakuzës, paraburgimi ne përcakton gjyqtari i procedurës paraprake dhe ai nuk mund të zgjasë më shumë se 8 ditë. Pas parashtrimit të aktakuzës deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor, paraburgimi mund të zgjasë deri në 60 ditë. Me këtë rast, kohëzgjatja e paraburgimit doemos të reduktohet në kohën më të shkurtër të domosdoshme, ndërsa gjykata dhe të gjitha palët janë të obliguara të veprojnë me urgjencë të veçantë.

Parimet e procedurës penale

Procedura penale bazohet në këto parime fondamente: 1) Parimi i gjykimit të drejtë, sipas të cilit personi i akuzuar për një vepër penale ka të drejtën për gjykim korrekt dhe publik para gjykatës së pavarur dhe të paanshme, në një procedurë kontradiktore të mundet t'i kontestojë akuzat kundër tij dhe të propozojë dhe shpalosë dëshmi në mbrojtje të tij. Ndër të tjera, element thelbësor i këtij parimi është ndalimi për gjykim ose dënim të dyfishtë që do të thotë se askush nuk mund të gjykohet ose të dënohet për një vepër për të cilën tashmë është dënuar me vendim të plotfuqishëm gjyqësor. 2) Parimi i akuzaritetit (parimi akuzues), sipas të cilit procedurë mund të iniciohet dhe të udhëhiqet vetëm në qoftë se ka kërkesë nga paditësi i autorizuar dhe ai e udhëheq procedurën penale. Ky parim i mundëson tri funksionet themelore në procedurën penale - ndjekjen, mbrojtjen dhe aktgjykimin – t'i kryejnë subjekte të ndryshme. Procedura penale mund të udhëhiqet vetëm kundër personit me të cilin k të bëjë aktakuza dhe vetëm për veprën që është përshkruar në aktakuzën. 3) Parimi i oficialitetit do të thotë se procedura penale mbahet sipas detyrës zyrtare nga ana e organeve shtetërore në interes

shoqëror. 4) Parimi i legalitetit të ndjekjes penale, që do të thotë se prokurori publik është i obliguar të ndërmarrë ndjekje penale për veprat penale që ndiqen sipas detyrës zyrtare sa herë që të jenë plotësuar kushtet ligjore. Nga ky parim ekzistojnë përjashtime të caktuara të cilat i lejojnë prokurorit publik ta vlerësojë përshtatshmërinë e ndjekjes penale, për shembull në procedurën kundër fëmijëve. 5) Parimi i kontradiktës sipas të cilit gjykata është e obliguar që t'i dëgjuar të dyja palët, prokurorin publik dhe të akuzuarin dhe avokatit të tij për të gjitha çështjet faktike dhe juridike që janë subjekt i debatit para gjykatës, ndërsa secili prej tyre ka të drejtë të propozojë dhe të paraqesë prova në mbështetje të teorisë së vet mbi rastin. 6) Parimi i shprehjes me gojë imponon që të gjitha dëshmitë, në seancën publike para gjykatës, të shpalosen gojarisht. Shprehja me gojë bën të mundur zbatimin më të lehtë të parimit të kontradiktës në debatin dhe përcaktimin e së vërtetës. 7) Parimi i drejtpërdrejtësisë sipas të cilit shpalosja e të gjitha fakteve dhe provave duhet të zhvillohet në një seancë publike para gjykatës, e cila të njëjtat i percepton direkt me shqisat e veta, në një procedurë kontradiktore.

Personi përgjegjës në subjektin juridik

Si person përgjegjës në subjektin juridik konsiderohet person i cili duke pasur parasysh funksionin e tij ose autorizimet e posaçme i është besuar një rreth i caktuar i punëve që kanë të bëjnë me zbatimin e dispozitave ligjore ose dispozitave të miratuara në bazë të ligjit ose të një akti të përgjithshëm të subjektit juridik në lidhje me menaxhimin, shfrytëzimin dhe disponimin e pasurisë, menaxhimin me procesin prodhues apo afarist, ndonjë proces tjetër ekonomik ose mbikëqyrjen mbi to. Si person përgjegjës konsiderohet edhe personi zyrtar kur bëhet fjalë për vepra te të cilat si kryerës është shënuar personi përgjegjës, ndërsa nuk janë parashikuar në kapitullin për

vepra penale kundër detyrës zyrtare në KP. Gjithashtu, si person përgjegjës konsiderohet personi i cili kryen një funksion të veçantë apo autorizim ose të cilit i është besuar kryerje e pavarur e punëve të caktuara në një subjekt juridik të huaj, si dhe personi që është përfaqësues i një subjekti të huaj juridik në Republikën e Maqedonisë.

Personi i cili kryen punë me interes publik
Si person që kryen punë me interes publik konsiderohet personi i cili kryen funksione, detyra ose punë me interes publik respektivisht të përgjithshëm, siç janë gazetar, noter, avokat, mësimdhënës, edukator, mjek, punonjës social ose person tjetër i cili këto punë i kryen në mënyrë të pavarur ose në një subjekt juridik që kryen veprimtari me interes publik ose të përgjithshëm të përcaktuar me ligj.

Përjashtimi i publikut nga debati kryesor
Nga parimi i përgjithshëm i publicitetit të seancës kryesore (shih më shumë), ekzistojnë rrethana që imponojnë përjashtimin e publikut. Bazat për përjashtimin e publikut patjetër të jenë legjitime respektivisht të parapara qartë me ligji, si për shembull kufizimi për zbardhjen dhe transmetimin e informacioneve të klasifikuara ose të dhënave që lidhen me dëshmitarë të mbrojtur, bashkëpunëtorët e drejtësisë dhe fëmijët, si dhe në rastet kur duhet të respektohet privatësia dhe të drejtat e palëve. Kështu, gjykata mundet në çdo kohë, sipas detyrës zyrtare ose me propozim të palëve ose të të dëmtuarit, ta përjashtojë publikun nga një pjesë e seancës gjyqësore apo nga e gjithë seanca, nëse një gjë e tillë është e nevojshme për të ruajtur një sekret shtetëror, ushtarak, ose të një sekreti të rëndësishëm zyrtar apo afarist, ruajtjen e rendit publik, mbrojtjen e jetës private të të akuzuarit, dëshmitarit ose të të dëmtuarit, mbrojtje të sigurisë së dëshmitarit ose të dëmtuarit dhe/ose mbrojtjen e interesave të fëmijës. Publiku mund të përjashtohet edhe

për shkak të natyrës dhe peshës së veprës, rrethanave në të cilat ajo është kryer, si dhe për shkak të rrethanave të tjera specifike (mosha, statusi i veçantë i dëshmitarit, etj). Gjykata është e obliguar të sjellë vendim për përjashtimin e publikut që patjetër të arsyetohet dhe të shpallet publikisht për rastin konkret. Përjashtimi i publikut nuk ka të bëjë me palët, të dëmtuarin, përfaqësuesit e tyre ligjorë dhe të autorizuarit e tyre, si dhe me avokatin, përveç në rastet e përcaktuara me ligj.

Përjashtimi i publikut nga hetimi – fshehtësia e hetimit

Publiku është plotësisht i përjashtuar në procedurën paraprake, respektivisht nga faza parahetimore ose i ashtuquajturi hetim policor, si dhe në fazën e hetimit. Të gjitha të dhënat në hetimin janë sekrete në interes të udhëheqjes së drejtë dhe të duhur të procedurës penale, zbardhjen e ngjarjes penale-juridike dhe mbrojtje të të drejtave dhe për përcaktimin e fajit të të dyshuarit dhe mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të njerëzve dhe të mirave të përgjithshme. Në veçanti, gjatë procedurës hetimore është e ndaluar të zbulohet identiteti i fëmijëve dhe identiteti i dëshmitarëve të mbrojtur. Procedurën e hetimit e udhëheq Prokuroria Publike dhe në të përfshihen policia e jurisprudencës dhe organet tjera kompetente shtetërore. Megjithatë, edhe krahas fshehtësisë së procedurës parahetimore dhe hetimore, gazetarëve duhet tu jepen informacione të sakta dhe objektive për rrjedhën e hetimit dhe të dhënat e anonimizuara për të dyshuarit/in. Këto të dhëna i ofron zyra e prokurorit publik kompetent që udhëheq hetimet në formë të komunikatave, deklaratave, intervistave, azhurnimit të faqes së internetit dhe të tjera. Të dhënat duhet të jenë relevante dhe të bëjnë me veprime të caktuara procedurale, të tilla si heqja e lirisë, vetëm me publikimin e inicialeve të personave ose se është kryer bastisje, inspektim dhe rikonstruktim. Diskrecioni

sigurohet edhe gjatë kur duhet të mbrohet jeta personale dhe familjare e palës së dëmtuar ose të dyshuarit. Në një rast të tillë, prokurori publik do të urdhërojë personin të cilin e ka marrë në pyetje, i cili është i pranishëm në veprimin hetimor ose i cili i shqyrton aktet, t'i ruajë si sekret të dhënat e caktuara dhe do ta paralajmërojnë për pasojat nga zbulimi i sekretit.

Përgjegjësia penale e personit juridik

Përgjegjësia penale e personave juridikë është një risi e madhe në legjislacionin tonë penal që u imponua nga shfaqja e formave të reja të krimit ekonomik dhe korporativ, krimit kompjuterik, krimit mjedisor, korrupsionit, pastrimit të parave. Fillimisht, personi juridik mban përgjegjësi penale për një vepër e cila është bërë nga personi përgjegjës (shih më shumë për personin përgjegjës) në emër, për llogarinë ose në dobi të personit juridik. Këtu bëhet fjalë për përgjegjësi të supozuar të personit juridik, më saktësisht, vepra e personit përgjegjës konsiderohet si vepër e personit juridik. Ekziston gjithashtu përgjegjësi edhe kur vepra penale është kryer nga punonjësi ose agjenti i tij, ndërsa me veprën është fituar dobi e konsiderueshme pasurore ose një tjetri i është shkaktuar dëm i konsiderueshme. Në këtë rast, duhet të përmbushen tre kushte: 1) ekzekutimi i konkluzionit apo një vendimi tjetër i organeve të subjektit juridik të paraqesë vepër penale, 2) të jetë lëshuar mbikëqyrja e detyruar dhe 3) organet kompetente të mos e kenë penguar veprën penale. Përgjegjësia e personit juridik nuk e përjashton përgjegjësinë e personit fizik. Personi juridik dënohet vetëm me gjobë.

Poseduesi i informatave

Me termin posedues i informacioneve, në pajtim me Ligjin për qasje të lirë deri tek Informatat, janë përfshirë organet

e autoritetit shtetëror, entet dhe institucionet tjera të përcaktuara me ligj, organet e komunave, të Qytetit të Shkupit dhe komunat në qytetin e Shkupit, institucionet dhe shërbimet publike, ndërmarrjet publike dhe personat juridikë dhe fizikë që kryejnë autorizime publike dhe veprimtari me interes publik të përcaktuara me ligj.

Prokurori publik

Prokurori publik i ndjek penalisht kryerësit e veprave penale për të cilët ndjekja merret përsipër nga prokuroria sipas detyrës zyrtare. Me qëllim të realizimit të funksionit të ndjekjes penale, prokurori publik udhëheq me procedurën parahetimore dhe hetimore dhe ka në dispozicion policinë gjyqësore. Më konkretisht, prokurori publik i ka këto të drejta dhe detyrat: 1) t'i kahëzojë veprimet e organeve përgjegjëse për zbulimin dhe raportimin e veprave penale dhe autorët e tyre, 2) të propozojë ose të lëshojë urdhër për ndërmarrjen e masave të veçanta hetuese, 3) të sjellë urdhër dhe të kryejë procedurë hetimore, 4) të zbulojë, propozojë dhe të sigurojë prova nën kushtet dhe në mënyrën e përcaktuar me ligj, 5) të propozojë masa të përkohshme për sigurimin e pasurisë ose sendeve të siguruara me një vepër penale ose për ekzekutimin e masës së konfiskimit, 6) të vendosë për shtyrjen e ndjekjes penale, 7) të negociojë dhe të bjerë në ujdi me të padituri në të pranojë fajësinë (shih më shumë), 8) të paraqesë dhe përfaqësojë akuza para gjykatës kompetente, 9) të parashtrojë ankesa kundër vendimeve të plotfuqishme gjyqësore dhe mjeteve të jashtëzakonshme juridike kundër vendimeve të plotfuqishme gjyqësore, 10) të vendosë mbi ankesën e palës së dëmtuar, dhe 11) të ndërmarrë veprime të tjera të përcaktuara me ligj. Prokurori publik dhe policia gjyqësore për një vepër penale mund të kuptojnë nëpërmjet vëzhgimit të drejtpërdrejtë, nëpërmjet denoncimit ose sipas akuzës së pranuar penale. Me qëllim

të grumbullimit të njoftimeve të nevojshme, prokurori publik mund ta thërrasë parashkruesin e kallëzimit penal, si dhe personat e tjerë për njohuritë e të cilëve konsideron se mund të kontribuojnë për të vlerësuar vlefshmërinë e pretendimeve në kallëzimin penal ose për të cilët konsideron se mund të jenë dëshmitarë në procedurë, me ç'rast i informon ata për arsyet e thirrjes (shih më shumë Prokuroria Publike).

Procedura e provave

Propozimi dhe shpalosja e provave në procedurën penale u është lënë në dispozicion palëve dhe gjykata nuk ka më një rol aktiv në procedurën e provave dhe në caktimin e së vërtetës. Gjatë procedurës së provave, dëshmitë sipas rregullës jepen sipas rendin në vijim: dëshmitë e aktakuzës, dëshmitë e mbrojtjes, dëshmitë e akuzës për refuzimin e provave të mbrojtjes (replika), dëshmitë e mbrojtjes si përgjigje të refuzimit (duplika) dhe prova që janë me rëndësi për përcaktimin e lartësisë së sanksionit penal.

Procedura penale

Procedura penale është një përmbledhje e veprimeve procesore që i ndërmarrin organet shtetërore (kryesisht gjykata, prokurori publik, policia gjyqësore dhe mbrojtësi), me qëllim që të mundësohet gjykim i drejtë, ashtu që asnjë person i pafajshëm të mos dënohet, ndërsa kryerësit të veprës penale t'i shqiptohet sanksion nën kushtet e parapara në Kodin Penal dhe në bazë të një procedure të zbatuar në mënyrë ligjore. Me LPP të ri, i cila zbatohet nga 1 dhjetori 2013, u aprovua një koncept i ri i procedurës penale. Risitë më të rëndësishme kanë të bëjnë me udhëheqjen e hetimit nga ana e prokurorit publik, rolin e gjyqtarit në procedurën paraprake dhe rënien në ujdi ndërmjet prokurorit dhe të padituri për llojin dhe lartësinë e sanksionit (shih më shumë për të gjitha këto risi).

Procedura penale - fazat
Procedura penale përbëhet nga fazat e mëposhtme: 1) procedura paraprake që përfshin procedurën paraprake dhe procedurën hetimore; 2) aktin paditës dhe vlerësimi e aktit paditës; 3) seanca kryesore dhe aktgjykimi; dhe 4) procedura për mjetet juridike, duke përfshirë mjetet juridike të rregullta dhe të jashtëzakonshme (shih më shumë për secilën fazë veç e veç).

Përgjegjësi për vepra të korrupsionit
Varësisht nga shkalla e rrezikut shoqëror të veprimit korruptive, është paraparë përgjegjësia penale dhe kundërvajtëse jo vetëm për personat fizikë, duke përfshirë edhe nëpunësit, personat përgjegjës dhe personat që kryejnë punë me interes publik, ashtu edhe për personat juridikë. Ndaj personave juridikë, mund të shqiptohet vetëm gjobë me para dhe ndalimi i ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës. Gjithashtu, personat fizikë mund t'i nënshtrohen përgjegjësisë për shkelje të rregullave dhe të disiplinës së punës, sjelljes etike dhe profesionale.

Përgjegjësia e gazetarëve dhe mediave për fyerje dhe shpifje
Ashtu si çdo person tjetër, gazetarët dhe mediat, mund të mbajnë përgjegjësi qytetare për fyerje dhe shpifje. Janë parashikuar shuma në para që mund t'i shqiptohen gazetarit dhe mediumit edhe atë deri në dy mijë euro për gazetarin/autorin e informacionit, deri në 10 mijë euro për kryeredaktorin dhe deri në 15 mijë euro për pronarin e mediumit.

Përgjegjësia e gazetarit për zbardhje të informatave
Gazetari mund të mbajë përgjegjësi civile dhe penale në qoftë se publikon informatë që nuk duhet të jetë e disponueshme për publikun. Nëse me këtë rast plotësohen elementet thelbësore të një vepre të caktuar penale,

gazetari mund të ndiqet për atë vepër penale. Në të gjitha rastet tjera bëhet fjalë për etikë gazetareske, e cila sidomos gjatë veprimit me informata të këtilla (pavarësisht nëse janë në dëm ose në favor të të pandehurve/të dëmtuarve) duhet të jetë në nivelin më të lartë profesional.

Përbërja në të cilën gjykojnë gjyqet e apelit
Punën nga kompetenca e vet gjykatat e apelit e kryejnë në këshille prej pesë gjyqtarësh për vepra penale për të cilat është përcaktuar burgim prej 15 vjet ose burgim i përjetshëm ose në këshill prej tre gjykatësve për vepra penale për të cilat ligji parashikon dënim më të butë. Kur gjykon në shkallë të dytë të debatit, këshilli përbëhet prej dy gjyqtarëve dhe tre porotëve. Seancat e këshillave gjyqësore në gjykatat e apelit, me përjashtim të seancave publike, mbahen pa praninë e publikut. Kryetari i gjykatës jep miratim për fotografimin e seancave publike.

Përbërja në të cilën gjykojnë gjyqet themelore
Në shkallë të parë, gjykatat gjykojnë në këshill prej pesë anëtarësh, këshill prej tre anëtarësh dhe gjyqtar individual. Këshilli pesë anëtarësh (dy gjyqtarë dhe tre gjyqtarë-porotë) merret me veprat penale për të cilat parashihet dënim me burg prej 15 vjetësh ose dënim me burg të përjetshëm, ndërsa këshilli tre anëtarësh (një gjyqtar dhe dy gjyqtarë-porotë) vendos për veprat penale për të cilat është parashikuar një dënim më i butë. Gjyqtari individual vepron mbi veprat penale për të cilat si dënim kryesor është paraparë dënimi me para ose dënim me burg deri në pesë vjet.

Përbërja në të cilën gjykon Gjyqi suprem
Gjykatës Supreme gjykon në këshilla të përbërë prej pesë gjyqtarësh. Në qoftë se është parashtruar kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër një vendimi të Gjykatës

Supreme, për kërkesën e Gjykatës Supreme vendos në seancë të përgjithshme (të gjithë gjyqtarët). Gjykata Supreme në seancë të përgjithshme është kompetente për të përcaktuar dhe shqyrtuar çështje të ndryshme në lidhje me punën e gjykatave dhe gjykatësve, zbatimin e ligjeve dhe njësimin e praktikës gjyqësore.

Personi juridik

Termi person (subjekt) juridik është shumë i gjerë dhe në përputhje me KP përfshin: Republikën e Maqedonisë, vetëqeverisjet lokale, partitë politike, ndërmarrjet publike, shoqëritë tregtare, institucionet, shoqatat, fondacionet, lidhjet dhe format organizative të organizatave të huaja, shoqatat sportive dhe subjektet e tjera juridike në fushën e sportit, fondacionet, organizatave financiare dhe organizatat tjera të përcaktuara me ligj të regjistruara si persona juridik dhe bashkësitë dhe organizatat e tjera të cilave u është njohur statusi i personit juridik. Me ternim person i huaj juridik nënkuptojmë një ndërmarrje publike, institucion, fond, bankë, shoq[ri tregtare apo formë tjetër të organizimit sipas ligjeve të një vendi të huaj në kryerjen e veprimtarive ekonomike, financiare, bankare, tregtare, shërbimeve ose aktivitete të tjera, që ka selinë e vet në një shtet tjetër, apo një zyrë përfaqësimi në Republikën e Maqedonisë, ose është themeluar si shoqëri, fond, bankë ose institucion ndërkombëtar.

Personi zyrtar

KP qartë i përkufizon dhe i përmban definicionet e termave person zyrtar, përgjegjës dhe person që kryen punë me interes publik, person i huaj zyrtar dhe juridik (neni 122). Gjegjësisht, si person zyrtar, kur ai është shënuar si kryerës i veprës penale konsiderohet: a) Presidenti i Republikës së Maqedonisë, ambasadorët dhe përfaqësues të tjerë të Republikës së Maqedonisë të vendosur jashtë vendit

dhe personat e emëruar nga Presidenti i Republikës së Maqedonisë, funksionari zgjedhur apo i emëruar në ose nga Kuvendi (kryetari, nënkryetarët dhe sekretari i Kuvendit), në Qeveria, në organet e administratës shtetërore, në gjykatat, Prokurorinë Publike, Këshillin Gjyqësor, Këshillin e prokurorëve publikë dhe organeve dhe organizatave tjera që kryejnë punë të caktuara profesionale, administrative dhe punë të tjera në kuadër të të drejtave dhe detyrave të Republikës, në njësitë e vetëqeverisjes lokale, si dhe personat të cilët vazhdimisht ose përkohësisht kryejnë detyrë zyrtare në këto organe dhe organizata; b) nëpunësi shtetëror i cili kryen punë profesionale, normative-juridike, ekzekutive, administrative-mbikëqyrëse dhe punë administrative në pajtim me Kushtetutën dhe me ligjin, c) personi i autorizuar në subjekt juridik të cilit me ligj ose me dispozitë tjetër të sjellë në bazë të ligjit i është besuar kryerja e autorizimeve publike, kur detyrën e kryen në kuadër të këtyre autorizimeve, si dhe personi i autorizuar për të përfaqësuar shoqatat, fondacionet, lidhjet dhe format tjera organizative të huaja, shoqatave sportive dhe subjekteve tjera juridike në sport, d) personi i cili kryen detyra të caktuara zyrtare në bazë të autorizimit të dhënë me ligj ose me dispozita tjera të bazuara në ligj, e) personi ushtarak kur bëhet fjalë për vepra penale te të cilat ku autori është shënuar si person zyrtar dhe f) përfaqësuesi i një shteti të huaj ose të një organizate ndërkombëtare në Republikën e Maqedonisë.

Policia gjyqësore

Policinë gjyqësore e përbëjnë nëpunësit policorë nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe nga pjesëtarët e Policisë Financiare dhe persona të autorizuar me ligj të Drejtorisë Doganore të cilët i vihen në dispozicion Prokurorisë Publike në zbulimin dhe ndjekjen e veprave penale dhe udhëheqjen e procedurës hetimore.

Policia financiare, kompetencat

Punë te Policisë financiare i kryen Drejtoria për policifinanciare, e cila është organ në përbërje të Ministrisë së Financave në cilësinë e personit juridik. Policia financiare kompetencat e saj i kryen në territorin e Republikës së Maqedonisë. Puna e Policisë financiare menaxhohet nga drejtori i cili emërohet dhe shkarkohet nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë me propozim të ministrit të financave. Për punën e tij dhe punën e Policisë financiare, drejtori përgjigjet para Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe ministrit të financave. Kompetencat e Policisë financiare janë: 1) zbulon dhe zbaton hetim kriminalistik të veprave penale të cilat ndiqen sipas detyrës zyrtare, siç janë: pastrimi i parave dhe të ardhurave tjera nga neni 273, tregti e paligjshme nga neni 277, kontrabandë nga neni 278, evazion fiskal nga neni 279 të Kodit penal dhe vepra të tjera penale me favore pasurore kundërligjore me vlerë të konsiderueshme, si dhe kapja dhe raportimi i autorëve të tyre, sigurimi i provave, masa dhe aktivitete të tjera të cilat mund të përdoren për udhëheqjen e papenguar të procedurës penale sipas detyrës zyrtare, ose me urdhër të prokurorit publik nëpërmjet ushtrimit të kompetencave të policisë gjyqësore në përputhje me ligjin; 2) grumbullon dhe analizon të dhënat mbi transaksionet në kesh, ndërmerr masa parahetimore dher masa të tjera kur ekzistojnë baza për dyshim për vepra të kryera penale, i ndjek gjurmët e parave, me qëllim që të zbulojë vepra të dënueshme të përcaktuara me ligj, bën inspektimin dhe shqyrtimin e të dhënave të kontabilitetit dhe evidencave në sistemet kompjuterike në prani të personit përgjegjës ose personit të autorizuar dhe kryen punë të tjera në pajtim me Ligjin për policinë financiare; 3) bën analizë kompjuterike forenzike për sistemet kompjuterike dhe pajisjet tjera elektronike të konfiskuara përkohësisht; 4) parashtron padi penale deri te prokurori publik kompetent për veprat penale nën kompetencën e tij, të cilat ndiqen sipas detyrës

zyrtare; 5) ngre iniciativë për fillimin e procedurës tatimore dhe ndonjë procedure tjetër për përcaktimin dhe pagesën e detyrimeve publike para organit kompetent; 6) koordinon, jep iniciativë, parashtron fletëparaqitje penale, bën shkëmbimin e informacioneve dhe organizon trajnime për personat e përfshirë në sistemin e parregullsive me qëllim që të mbrojë interesat financiare të Republikës së Maqedonisë dhe Bashkimit Evropian; 7) përgatit dhe dorëzon projekt-strategji për mbrojtjen e interesave financiare të Republikës së Maqedonisë dhe Bashkimit Evropian dhe 8) kryen detyra të tjera të përcaktuara me ligj.

Prokuroria themelore publike për ndjekjen e krimit të organizuar dhe korrupsionin

Prokuroria publike themelore për ndjekjen penale të krimit të organizuar dhe korrupsionit vepron në territorin e gjithë shtetit. Titulli i saj tregon se ka juridiksion të specializuar për të trajtuar veprat më të rënda dhe veprat korruptive që janë kryer nga një grup kriminal i organizuar. Më konkretisht, kjo publike themelore e specializuara vepron: 1) për veprat penale të kryera nga një grup i strukturuar prej tre ose më shumë personave, që ekziston për një periudhë kohore dhe që vepron me qëllim që të kryejë një ose më shumë vepra penale për të cilat është paraparë dënim prej së paku katër vitesh, me synimin për direkt ose indirekt të ketë përfitime financiare ose përfitime tjera; 2) për vepra penale të kryera nga një grup i strukturuar apo organizatës kriminale në territorin e Republikës së Maqedonisë ose në një shtet tjetër ose kur vepra penale është përgatitur ose është planifikuar në Republikën e Maqedonisë ose në një shtet tjetër; për vepra penale abuzim i pozitës zyrtare apo autorizimit në bazë të nenit 353 paragrafi (5), marrje ryshfet në vlerë të konsiderueshme nga neni 357 dhe ndërmjetësim kundërligjor nga neni 359 të gjitha nga KP, të kryera nga një funksionar i zgjedhur apo i emëruar, person zyrtar

ose person përgjegjës në subjekt juridik; dhe 3) për vepra penale prodhim i paautorizuar dhe shpërndarje e drogave narkotike, substancave psikotrope dhe prekursorëve nga neni 215 paragrafi (2), pastrim të parave dhe të ardhurave tjera me vlerë më të madhe nga neni 273, rrezikim terrorist i rendit kushtetues dhe sigurisë nga neni 313, dhënie ryshfet me vlerë të konsiderueshme nga neni 358, ndikim i paligjshëm mbi dëshmitarët sipas nenit 368 dhe paragrafit (3), bashkim kriminel nga neni 394, organizatë terroriste sipas nenit 394-a, terrorizëm në bazë të nenit 394-b, vepra penale trafikim me qenie njerëzore nga neni 418-a, vepra penale kontrabandë me migrantë nga neni 418-b, trafikimi me të mitur në bazë të nenit 418-d dhe vepra të tjera penale kundër njerëzimit dhe të drejtës ndërkombëtare nga Kodi Penal, pavarësisht nga numri i kryerësve.

Prezumimi i pafajësisë

Parimi i prezumimit të pafajësisë, paraqet garanci se personi i dyshuar ose i akuzuar për një vepër penale do të konsiderohet si i pafajshëm derisa fajësia e tij nuk caktohet me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor. Mediat, organet shtetërore dhe të gjithë personat e tjerë janë të detyruar t'i përmbahen këtij parimi themelor. Me deklaratat e tyre publike për procedurën që është në vijim, ata nuk guxojnë të shkelin të drejtat e të pandehurit dhe të dëmtuarit, si dhe pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqësorit. Kjo e drejtë është e garantuar me Kushtetutën e RM, LPP dhe nenin 6 të KEDNJ-së. Person i cili konsideron se i është cenuar e drejta për prezumimin e pafajësisë, mund të kërkojë mbrojtje para organeve gjyqësore vendase dhe ndërkombëtare.

Procedura paraprake - procedura parahetimore dhe hetimore

Procedura paraprake si fazë e parë e procedurës penale përbëhet nga procedura parahetimore dhe hetimore, me

të cilën udhëheq dhe e zbaton prokurori publik kompetent, me ç'rast e ka në dispozicion policinë gjyqësore. Gjatë procedurës parahetimore zbatohen hetime dhe veprime nga ana e policisë dhe prokurorit publik me qëllim që të zbulohet kryerësi ose të pengohet të arratiset, të zbulohen dhe të sigurohen gjurmët e veprës penale dhe sendet që mund të shërbejnë si provë, si dhe të mblidhet të gjitha informacionet që mund të jenë të dobishme për zhvillimin e suksesshëm të procedurës penale. Policia gjyqësore është e obliguar të veprojë sipas urdhrave dhe kaheve të prokurorit publik, por megjithatë policia mund të vazhdojë me vëzhgimet edhe kur nuk ka urdhra të veçanta apo kahe nga prokurori publik, ndërsa për masat e zbatuara dhe veprimet e informon prokurorin publik. Procedura hetimore si pjesë e procedurës paraprake, iniciohet kundër një personi të caktuar, kur ekziston dyshim i bazuar se ka kryer vepër penale për të cilën ndiqet sipas detyrës zyrtare ose me propozim Gjatë procedurës hetimore mblidhen provat dhe të dhënat që i janë të nevojshme prokurorit publik që të mund të vendosë nëse do të parashtrojë padi ose do të heqë dorë nga ndjekja penale, si dhe jepen provat për të cilat ekziston rreziku se nuk do të mund të jepen në seancën kryesore ose se shpalosja e tyre do të bëhej me vështirësi. Në këtë rast, prokurori publik është i obliguar të mbledhë dëshmi që shkojnë si në dëm të të dyshuarit ashtu edhe në favor të tij. Gjatë procedurës hetimore, prokurori publik mund t'i ndërmarrë veprimet e mëposhtme hetimore: bastisje, sigurim dhe sekuestrim i përkohshëm i sendeve ose pasurisë, marrje në pyetje të të dyshuarit, marrje në pyetje të dëshmitarëve, përcaktimin e ekspertizë, këqyrje dhe rikonstruktim dhe masa të posaçme hetimore. Procedurat parahetimore dhe hetimore janë sekrete, respektivisht të gjitha veprimet e ndërmarra nga ana e prokurorit publik ose policia konsiderohen sekrete.

Pranimi ose prononcimi për fajin
Gjatë seancës kryesore, i akuzuari thirret për tu prononcuar nëse ndjehet fajtor apo jo në lidhje me të gjitha veprat penale me të cilat ngarkohet me aktakuzën. Me këtë rast, nëse i akuzuari pranon fajësinë gjatë seancës kryesore, kryetari i këshillit gjykues është i obliguar të shqyrtojë nëse pranimi është dhënë vullnetarisht, nëse i akuzuari është i vetëdijshëm për pasojat juridike nga pranimi i fajësisë, si dhe për pasojat lidhur me kërkesën pronësore-juridike dhe shpenzimet e procedurës penale. Pastaj, në procedurën e provave do të shpalosen vetëm ato dëshmi që kanë të bëjnë me vendimin mbi sanksionin. Në një rast të tillë, i pandehuri nuk mund të parashtrojë ankesë për shkak të gjendjes faktike të konstatuar gabimisht. Në qoftë se i akuzuari nuk e pranon fajin, palët fillojnë me prezantimin e dëshmive që janë të lidhura si me veprën penale dhe fajin, ashtu dhe me provat relevante për përcaktimin e llojit dhe përcaktimin e lartësisë së sanksionit penal.

Procedurë e shkurtuar penale
Procedura e shkurtuar udhëhiqet për ato vepra penale për të cilat ligji parashikon gjobë me para ose dënim me burg deri në pesë vjet. Kjo procedurë zhvillohet në bazë të propozimit akuzues të prokurori publik ose në bazë të padisë private.

Publiciteti në procedurën penale
Parimi i publicitetit është një nga parimet mbi të cilat fle procedura penale në secilin shtet demokratik që bazohet në sundimin e së drejtës dhe respektimin dinjitoz të lirive dhe të drejtave të të gjithë qytetarëve. Parimi i publicitetit në shqyrtimin kryesor dhe shpallja e aktgjykimit është parim kushtetues. Kushtetuta si akti më i lartë juridik përcakton që seancat gjyqësore të jenë publike, ndërsa LPP përcakton se procedura penale

është publike, me përjashtim të procedurës paraprake respektivisht parahetimore dhe hetimit. Gjithashtu, Ligji për parandalimin e korrupsionit përmban një dispozitë me të cilën parashihet një dispozitë e përgjithshme me të cilën parashihet se askush nuk mund ta përjashtojë publikun nga seanca për korrupsion para organit kompetent ose personit juridik, përveç kur bëhet fjalë për procedurë paraprake që është shpallur si konfidenciale. Sipas KEDNJ, çdokush ka të drejtë për një gjykim korrekt dhe publik, brenda një afati të arsyeshëm, para një gjykate të pavarur dhe të paanshme të vendosur me ligj të rishikohen dhe përcaktohen të drejtat dhe obligimet e tija qytetare ose të bazueshmërisë së çdo akuze penale kundër tij. Aktgjykimi shqiptohet publikisht, ndërsa gazetarët dhe publiku mund të përjashtohen gjatë gjithë procedurës ose të një pjese të saj në interes të drejtësisë, moralit, rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, ose kur një gjë të tillë e imponojnë interesat e fëmijëve dhe mbrojtja e jetës private të palëve. Gjykimet në parim janë publike, përveç rasteve të parashikuara me ligj. Kjo do të thotë që publiku i përgjithshëm dhe gazetarët nuk mund të përjashtohet në përgjithësi nga gjykimi, por këshilli gjykues i cili e udhëheq seancën do të marrë vendim, të cilin do ta publikojë para të pranishmëve në sallën e gjyqit dhe në këtë mënyrë të gjithë do të jenë të informuar për arsyet që çuan deri tek ajo që gjykata të vendosë ta përjashtojë publikun nga lënda e caktuar.

Publiciteti në lidhje me punën e gjykatës

Publiciteti në punën e gjykatës sigurohet në disa mënyra: përmes publikimit të të dhëna për numrin e lëndës, gjyqtarit, datës, orës dhe sallës së gjyqit ku do të zhvillohet seanca; publikimi i raportit vjetor për rezultatet e punës së gjykatës dhe gjyqtarëve. Me qëllim të informimit të hapur dhe objektivi të publikut për punën

e gjykatës nëpërmjet mjeteve të informimit, kryetari i gjyqit ose personi përgjegjës për marrëdhënie me publikun i caktuara nga kryetari i gjyqit jep informata për punën e gjykatës, respektivisht për ecurinë e procedurë mbi një lëndë të caktuar. Kryetari i gjyqit dhe personi përgjegjës për marrëdhënie me publikun japin informata për publikun, duke mbajtur llogari për atë që të mos dëmtohet reputacioni, nderin dhe dinjiteti i personalitetit, respektivisht pavarësia dhe paanshmëria e gjyqit.

R

Rikonstruktimi i ngjarjes

Me rikonstruktimin, si mjete dëshmues, kontrollohen provat e siguruara ose përcaktohen faktet që janë relevante për zbardhjen e rastit. Rikonstruktimi i ngjarjes penale-juridike kryhet ashtu që do të përsëriten veprimet ose situatat në të njëjtat kushte nën të cilat, sipas dëshmive të mbledhura, është zhvilluar ngjarja. Nëse në deklaratat e dëshmitarëve ose të dyshuarve të caktuar, respektivisht të akuzuarve, veprimet ose situatat janë paraqitur ndryshe, rikonstruktimi i ngjarjes, si rregull, do të kryhet veç e veç me secilin prej tyre. Po ashtu, sipas nevojës mundet përsëri të shpalosen si nga dëshmitë. Rikonstruktimi mund të zbatohet në përdorimin në tërësi ose pjesërisht me shfrytëzim të simulimeve kompjuterike. Me këtë rast, rikonstruktimi nuk guxon të bëhet ashtu që të ofendojë rendin dhe moralin publik ose të rrezikojë jetën apo shëndetin e njerëzve. Në rikonstruktim apo këqyrje mund të ftohet ekspert, nëse prania e tij do të ishte në favor të dhënies gjetje apo mendim.

S

Sanksionet penale

Kodi penal i rregullon llojet e sanksioneve penale, përmbajtjen dhe qëllimin e tyre, i përcakton kushtet për shqiptimin e tyre. Kështu, sanksionet penale janë dënimet,

masat alternative, masat e sigurisë dhe masat edukative (pluralitet ndëshkimesh). Sanksioni penal i ka elementet thelbësore me sa vijon: e para, ai paraqet pasojë themelore juridike që e godit shkelësin për shkak të veprës së kryer penale; e dyta, është një masë e dhunshme të cilën e shqipton gjyqi; dhe e treta, konsiston në sekuestrimin ose kufizimin e lirive dhe të drejtave të caktuara të kryerësit ose mjekimin e tij të dhunshëm ose trajtimin e lirisë. Qëllimi kryesor i sanksioneve është përgjigjja e drejtë për veprën e kryer penale (retribucion) dhe ndikimin edukativ mbi kryerësin dhe personat e tjerë që të mos kryejnë vepra penale (preventivë speciale dhe gjenerale). Gjatë shqiptimit të sanksionit penal, gjykata duhet të udhëhiqet nga përcaktimi parimor për aplikim restriktiv të dënimeve me burg dhe dënimeve të tjera për vepra më rënda penale nga njëra anë, dhe aplikimin e masave alternative për vepra më të lehta penale (ato për të cilat është përcaktuar gjobë ose dënim me burgim deri në tre vjet).

Shqiptimi dhe shpallja e aktgjykimeve

Pas përfundimit të seancës kryesore, këshilli gjykues tërhiqet për këshillim dhe votim për të sjellë vendimin. Aktgjykimi shqiptohet dhe shpallet publikisht "në emër të qytetarëve të Maqedonisë." Kryetari i këshillit gjykues do ta lexojë publikisht deklaratën e aktgjykimit dhe do t'i elaborojë arsyet. Të gjithë të pranishmit, shqiptimin e aktgjykimi e dëgjojnë duke qëndruar në këmbë. Pas shpalljes së aktgjykimit, palët udhëzohen për të drejtën e apelimit dhe përgjigjes ndaj ankesës. Në qoftë se gjykata nuk është në gjendje të shpallë aktgjykimin në të njëjtën ditë pas seancës kryesore, do ta shtyjë shpalljen e aktgjykimit më së voni për tre ditë dhe do ta përcaktojë kohën dhe vendin e shpalljes së aktgjykimit. Aktgjykimi gjithashtu shpallet publikisht në rastet kur publiku ka qenë i përjashtuar nga seanca kryesore. Pastaj vijon përgatitja

me shkrim dhe dorëzimi i aktgjykimit. Aktgjykimi që është shpallur patjetër të përpilohet me shkrim që në afat prej 15 ditëve pas shpalljes, ndërsa te lëndët e ndërlikuara si përjashtim në afat prej 60 ditëve.

Shqyrtimi kryesor, ecuria

Shqyrtimi kryesor është faza qendrore e procedurës penale. LPP e përshkruan rrjedhën e shqyrtimit, duke përcaktuar rendin e saktë sipas të cilit ndërmerren të gjitha veprimet procedurale. Para hapjes së debatit, gjyqtari individual apo kryetari i këshillit gjykues duhet të konstatojë nëse janë plotësuar supozimet ligjore për shqyrtimin kryesor, dhe se nuk ka pengesa procedurale për mbajtjen e tij dhe se palët janë ftuar në mënyrë të rregullt. Shqyrtimi kryesor zhvillohet sipas ecurisë në vijim: 1) Fjalët kryesore të palëve - secila palë e paraqet shkurtimisht pikëpamjen e vet për rastin dhe e bën publik materialin provues. 2) Prononcimi i të padituri për fajin - pas njohurisë së dhënë për të drejtat e të akuzuarit, gjyqi e fton të padituri të prononcohet nëse ai ndihet fajtor për veprat penale për të cilat ngarkohet me aktakuzën. 3) Procedura e bazuar në dëshmi - nëse i padituri nuk e pranon fajin, atij i ofrohet të japë provat. 4) Marrja në pyetje e të padituri - kjo është e mundur vetëm me propozim të mbrojtjes. 5) Fjalët përfundimtare - pas përfundimit të procedurës së provave, gjykata e fton paditësin, të dëmtuarin, avokatin mbrojtës dhe të akuzuarin që të thonë fjalët e tyre përfundimtare. 6) Përfundimi i shqyrtimit kryesor – këshilli gjykues tërhiqet në këshillim dhe votim për të sjellë aktgjykimit. 6) Shqiptimi dhe shpallja publikimi e aktgjykimit - aktgjykimi shqiptohet "në emër të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë" dhe gjithmonë bëhet publik (shih më shumë për shqiptim dhe shpallje të aktgjykimit).

Të drejtat e të padituritit

Të drejtat themelore të të padituritit në procedurën penale janë: të jetë i informuar me kohë dhe në mënyrë të detajuar, në gjuhën që e kupton, për veprat për të cilat ngarkohet dhe për provat kundër tij; të ketë kohë dhe mundësi të mjaftueshme për ta përgatitur mbrojtjen e tij, e në veçanti për të ketë qasje në dosjen e lëndës dhe për të jetë i njoftuar me provat kundër tij dhe provat në favor të tij; të komunikojë lirisht me mbrojtësin e zgjedhur prej tij; të gjykohet në praninë e tij dhe të mbrohet personalisht ose me ndihmën e mbrojtësit të zgjedhur prej tij, ndërsa në qoftë se nuk ka mjete për të paguar avokatin mbrojtës, t'i jepet avokat pa pagesë në rastet e parashikuara me ligj; ta shpalosë drejtpërdrejt mbrojtje e tij para gjyqit; të mos jetë i detyruar të japë deklaratë kundër vetes ose personave të afërt ose të pranojë fajin; të ketë mundësi për të prononcohet për faktet dhe provat që i ngarkohen dhe t'i shpalosë të gjitha faktet dhe provat që shkojnë në favor të tij; vetë ose nëpërmjet mbrojtësit t'i marrë në pyetje dëshmitarët kundër tij, si dhe për t'i sigurohet prani dhe marrje në pyetje dëshmitarët në favor të tij nën kushte të njëjta, si dhe dëshmitarët kundër tij, si dhe gjatë shqyrtimit kryesor të këshillohet me avokatin e tij dhe të drejtën e mjeteve juridike.

Transparenca

Transparenca si një prej parimeve themelore të qeverisjes së mirë, është esenciale që publiku të ketë informacion dhe qasje se si të mblidhen, të shpërndahen dhe të shpenzohen paratë publike. Përveç kësaj, transparenca është e domosdoshme që të tregohet se cili është vullneti dhe qëllimi i institucioneve publike për të informuar publikun dhe për të ndarë këto informata me ta. Transparenca, gjithashtu paraqet mjet për përparimin e menaxhimit me sektorin publik. Transparenca e forcon zërin e qytetarëve,

duke i ndihmuar ata që të ndikojnë mbi marrjen e vendimeve në mënyrë të drejtpërdrejtë, nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të zgjedhur në parlament dhe përmes procesit politik. Krijimi i informacioneve me të cilat shpalosen qëllimet, aktivitetet dhe pasojat mbi sektorin publik është gjithashtu e domosdoshme, por nuk jo e mjaftueshme për të arritur nivelin e kënaqshëm të llogaridhënies. Transparenca fiskale është element i rëndësishëm për menaxhimin efektiv me financat publike, ndihmon në ndërtimin e mirëbesimit të publikut në punën e institucioneve publike dhe kontribuon për qëndrueshmërinë në zbatimin e politikave publike. Transparenca, gjithashtu paraqet një dritare kah puna buxhetore e shtetit, duke i ndihmuar publikut që ta ftojë pushtetin në përgjegjësi. Transparenca fiskale është pjesë e nocionit më të gjerë të transparencës dhe qasjes në informata në sektorin publik. Transparenca ka dy dimensione të ndryshme: e para, qasja në informata që lidhen me proceset dhe procedurat në bazë të të cilave sektori publik ndërmerr dhe zbaton vendimet; dhe e dyta, qasja në informata të pronësi të sektorit publik. Transparenca fiskale i referohet të gjitha mjeteve dhe obligimeve të sektorit publik, si dhe të hyrave dhe shpenzimeve të aprovuara nga buxheti vjetor i miratuar. Ajo përfshin publikimin e informacioneve fiskale, përfshirja e qytetarëve në krijimin e politikave fiskale dhe marrjen e vendimeve fiskale. Transparenca fiskale zakonisht definohet dhe matet sipas disponueshmërisë dhe cilësisë së informatave që kanë të bëjnë me vendosjen institucionale në menaxhimin me financat publike dhe operacionet ekzistuese dhe të planifikuara financiare në sektorin publik. Transparenca fiskale është sidomos e rëndësishme sepse mundëson që qytetarët, kreditorët e shtetit, investitorëve dhe pjesëmarrësit në tregjet financiare në mënyrë precize ta masin pozicionin financiar të shtetit dhe t'i konstatojnë shpenzimet reale de përfitimet nga aktivitetet dhe masat qeveritare, përfshirë implikimet e tyre aktuale

dhe perspektive ekonomike dhe sociale. Disponueshmëria e informata ve fiskale kontribuon në reduktimin e rreziqeve të tregut dhe diskrepancën në posedimin e informatave, duke u mundësuar tregjeve të funksionojnë në mënyrë më efikase.

VP – Dhënia e ryshfetit

Kjo VP është e paraparë me nenin 358 të KP. Dhënia e ryshfetit sipas veprimit të kryerjes dhe objektit të mbrojtjes është shumë e ngjashme me veprën pranim i ryshfetit. Këto dy vepra, si vepra klasike të korrupsionit, janë të lidhura ngushtë me njëra-tjerën, ku ato mund të ekzistojnë veç e veç ose të kryhen në korelacion (sekret) midis ofruesit dhe marrësit të ryshfetit. Dhënien e ryshfetit ose të ashtuquajturën mitë aktive e bën cilido person, për dallim nga marrja e ryshfetit ku si kryerës mund të paraqitet vetëm personi zyrtar, personi përgjegjës ose një person që kryen punë me interes publik (shih më shumë rreth VP – marrja e ryshfetit). Vepra ekziston kur kryerësi direkt ose indirekt, personit zyrtar do ta japë, do t'i premtojë ose do t'i ofrojë një dhuratë apo përfitim tjetër për të ose për tjetërkënd. Ekzistojnë dy forma të kësaj vepre: 1) E para, kur i jepet premtim ose dhuratë apo përfitim tjetër personit zyrtar për të kryer një veprim zyrtar të cilin nuk do të guxonte ta bëjë apo që të mos kryejë veprim zyrtar të cilin do të ishte i detyruar ta bëjë ose ndërmjetëson për këtë. Për këtë formë të ryshfetit të drejtpërdrejtë aktiv, parashihet dënimi me burg prej një deri në pesë vjet. 2) E dyta, kur jepet premtim ose dhuratë apo përfitim tjetër personit zyrtar për të kryer një veprim zyrtar që do ishte patjetër ta kryejë ose të mos kryejë një veprim zyrtar të cilin nuk do të guxonte ta kryejë ose të ndërmjetësoj në këtë. Për këtë formë të të ashtuquajtur ryshfet ilegal indirekt, parashihet burgim prej një deri në tre vjet. Gjykata mund ta lirojë nga dënimi kryerësin i cili ka dhënë ose ka premtuar

ryshfet sipas kërkesës së personit zyrtar dhe ta denoncojë para se të kuptojë se vepra është zbuluar. Kjo vepër i referohet edhe personit përgjegjës, personit përgjegjës në një subjekt juridik të huaj, personit i cili kryen punë me interes publik dhe person zyrtar i huaj. Për këtë vepër parashikohet përgjegjësi penale e personit juridik. Dhurata e dhënë ose përfitimi pasuror konfiskohen.

VP- Evazioni fiskal

Kjo VP është e rregulluar me nenin 279 të KP.

Edhe pse evazion fiskal është një vepër e përgjithshme penale dhe mund të kryejë secili person e jo vetëm ai zyrtar, megjithatë është e rëndësishme të dihen karakteristikat e tij ligjore për shkak të faktit se ka një tendencë të mos raportimin apo fshehjes së "pasurisë së fituara ilegalisht" dhe mospërmbushjes së obligimeve tatimore dhe obligimeve të tjera fiskale ndaj shtetit. Ekzistojnë dy forma të kësaj vepre 1) kur kundërvajtësi, me qëllim që ai vetë apo një tjetër person, të shmangë plotësisht ose pjesërisht pagesën e tatimit, kontributeve ose të ndonjë detyrimi tjetër për të cilin është e obliguar me ligj, jep informacione të rreme në lidhje me të ardhurat e tija ose të ardhurat e subjektit juridik, sendeve ose fakteve tjera me ndikim për përcaktimin e shumës së detyrimeve të këtilla dhe 2) kur shkelësi me të njëjtin qëllim, në rastin e fletëparaqitjes së obligueshme nuk raporton të ardhurat, respektivisht send ose ndonjë fakt tjetër për vërtetimin e detyrimeve të tilla, ndërsa shuma e detyrimit është me vlerë të madhe. Për veprën parashihet dënim me burg prej gjashtë muaj deri në pesë vjet dhe gjobë. Në qoftë se shuma e detyrimit është e konsiderueshme, është paraparë dënim me burg prej së paku katër vjet dhe gjobë. Si kryerës i veprës mund të paraqitet edhe një person juridik, në të cilin rast shqiptohet gjobë.

VP – Abuzimi me sekretin, zyrtar ose ushtarak
Vepra rregullohet me nenin 360-a të KP.
Si subjekt i veprës paraqitet një person zyrtar i cili do të shfrytëzojë të dhëna që përbëjnë sekret shtetëror, sekret zyrtar ose ushtarak me qëllim të marrjes për vete ose për një tjetër ndonjë përfitim ose shkaktim i dëmit dikujt tjetër. Përgjegjësia ekziston edhe pas ndërprerjes së shërbimi, në qoftë se me të njëjtin qëllim personi i shfrytëzon të dhënat e tilla ose i komunikon ato, i dorëzon ose i vë në dispozicion të tjetërkujt për përdorim. Për veprën parashihet dënim me burg prej tre muaj deri në pesë vjet.

VP – Abuzimi me procedurën për thirrje publike, ndarja e kontratës për prokurim publik ose partneritet publiko-privat
Kjo vepër kundër financave publike rregullohet me nenin 275-c të KP.
Verpa konsiston në një shkelje të vetëdijshme respektivisht të qëllimshme dhe keqpërdorim të dispozitave për prokurime publik, në veçanti dispozitat sipas të cilave zbatohet procedura për thirrje publike dhe ndahen kontrata për prokurime publike ose partneritet publiko-privat, ndërsa me qëllim të realizojë për vete ose për tjetërkënd përfitim më i madh pronësor.Veprimi i realizimit mund të përbëhet nga dorëzimi i dokumentacionit të rremë, negocim me pjesëmarrës tjerë të mundshëm për të bërë mashtrim në procedurën për dhënien e kontratave publike, mospërmbushje e detyrimeve kontraktuale me qëllim që të abuzohet me kontratën ose në ndonjë mënyrë tjetër qëllimisht të shkelen rregullat për qëllime eukrative ose shkaktohen një dëm më i madh. Për këtë formë themelore të veprës, parashihet gjobë ose burg deri në tre vjet. Në rast se me kryerjen e veprës është krijuar një pasuri e konsiderueshme ose janë bërë dëme të konsiderueshme, shqiptohet dënimi me burg prej të paktën katër vjetësh. Nëse bëhet fjalë për përfitim pronësor

me përmasa më të madhe ose dëm të përmasave më të mëdha, do të shqiptohet dënim me burg prej të paktën pesë vjetësh. Kryerësit i shqiptohet edhe ndalim i ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës. Nëse veprën e kryen një person juridik, do të ndëshkohet me gjobë dhe ndalimi të pjesëmarrjes në procedurat për dhënien e kontratave për prokurim publik.

VP – Keqpërdorimi i pozitës zyrtare dhe autorizimit
Kjo VP është paraparë me Nenin 353 të KP.
Objekti primar i mbrojtjes paraqet "përmbushje të ligjshme, të ndërgjegjshme dhe të drejtë të autorizimeve zyrtare, publike dhe autorizimeve të tjera". Gjithashtu, me këtë vepër mbrohen liritë themelore dhe të drejtat e qytetarëve dhe raporti i besimit të qytetarëve ndaj zotëruesve të autorizimeve dhe detyrave zyrtare dhe publike. Subjekt ose kryerës i një VP është personi zyrtar, ndërsa veprimi i kryerjes konsiston në shfrytëzimin, tejkalimin dhe mosrealizimin e autorizimi zyrtar. Kjo VP ekziston në tri raste: 1) kur personi zyrtar shfrytëzon pozitën ose autoritetin e tij zyrtar për të ndërmarrë një veprim të caktuar (nuk ekziston abuzimi në aspektin formal, por në aspektin material); 2) do t'i tejkalojnë kufijtë e autorizimeve të tija zyrtare (p.sh., falsifikim i dokumentit, por nuk ka tejkalim në qoftë se veprimi nuk është në lidhje me ndërmarrjen e veprimit zyrtar, si për shembull vjedhje; ose 3) personi zyrtar nuk do ta kryejë obligimin e tij zyrtar. Në të gjitha rastet, personi zyrtar merr për vete ose për dikë tjetër ndonjë përfitim ose tjetrit i shkakton dëm. Përfitimi ose dëmi mund të jetë i një natyre materiale ose jomateriale. Me përfitim të dobisë për tjetërkënd nënkuptohet edhe dobia që krijohet për organin në të cilin kryesi punon. Për këtë VP është parashikuar dënim me burg prej gjashtë muaj deri në tre vjet. Për forma më të rënda të kësaj vepre, si marrja e përfitimit të madh ose të konsiderueshëm, dënohen më rreptë: me dënim me burg

prej gjashtë muaj deri në tre respektivisht pesë vjet. Element kualifikueset që mbart dënim me burg prej të paktën pesë vjet, është në qoftë se keqpërdorimi është i detyrës zyrtare është bërë në kryerjen e prokurimit publik apo në dëm të mjeteve të buxhetit të Republikës së Maqedonisë, nga fondet publike dhe mjetet tjera të shtetit.

VP – Mashtrim në shërbim

Kjo VP është e rregulluar me nenin 355 të KP.

Për këtë vepër penale kërkohet vepër dhe qëllim i inkriminuar për të realizuar një përfitim të caktuar. Gjegjësisht, personi zyrtar i cili gjatë kryerjes së detyrës, me qëllim që për vete ose për dikë tjetër të përfitojë dobi të kundërligjshme pasurore, do të paraqesë llogari false ose në ndonjë mënyrë tjetër do të mashtrojë ndonjë person të autorizuar që të bëjë pagesë të paligjshme, do të dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në pesë vjet. Krahas personit zyrtar, ligji parashikon përgjegjësinë edhe për personin përgjegjës në një subjekt të huaj juridik që ka zyrë përfaqësimi ose kryen veprimtari në Republikën e Maqedonisë, ose person që kryen punë me interes publik.

VP – Pranim i paautorizuar i dhuratave
– VP Dhënie e paautorizuar e dhuratave

Këto vepra janë të rregulluara me nenin 253 dhe nenin 253-a të KP.

Me këto vepra inkriminohet sjellja korruptive në kryerjen e veprimtarisë ekonomike, financiare, tregtare, shërbyese ose ndonjë veprimtari tjetër ekonomike në sektorin privat. Të dy veprat janë në relacion të ngushtë reciprok, siç është rasti me dhënien dhe marrjen e ryshfetit, por megjithatë ato mund të ekzistojnë veç e veç.

Te pranimi i paautorizuar i dhuratave kryerës mund të jetë secili person, ndërsa veprimi i kryerjes përbëhet nga të kërkuarit ose të pajtuarit direkt apo indirekt të marrë për

veten e tij ose për një tjetër dhuratë apo përfitim tjetër drejtpërdrejtë ose të tërthortë ose premtim ose ofertë për përfitim të tillë. Ekzistojnë tre forma të veprës: 1) Kur personi e ndërmerr veprimin e përshkruar me qëllim që t'i lë pas dore interesat e personit juridik ose fizik për të krijuar përfitim të paarsyeshëm ose të shkaktojë dëm me vlerë më të madhe për personin fizik ose juridik ose për personin e tretë. 2) Kur personi e ndërmerr veprimin që të mos lidhë ose vazhdojë kontratë ose të mos ndërmerret ndonjë veprim i mëtejshëm në favor të personit juridik ose fizik interesat e të cilit i përfaqëson. Për këto dy forma është paraparë dënim me burgim prej një deri në pesë vjet 3) Kur personi do të pajtohet të pranojë dhuratë në mënyrë të paautorizuar apo përfitim tjetër pas lidhjes së kontratës ndërmarrjes ose mosndërmarrjes t një veprimi tjetër, në të cilin rast është paraparë ndëshkim me gjobë ose me burgim deri në tre vjet. Dhurata e pranuar ose përfitimi tjetër, konfiskohen. Ligji parashikon përgjegjësi të personave juridikë.
Vepra dhënie e paautorizuare e dhuratave në një mënyrë krejtësisht identike i inkriminon aktet e kryerjes së veprës, që në këtë rast është personi i cili do t'i ofrojë ose do t'i japë tjetrit dhuratë apo përfitim tjetër ose premtim apo ofertë për dobi të tillë në rastet dhe nën rrethanat që janë shpjeguar më lart te pjesa pranimi i paautorizuar i dhuratave.

VP – Puna e papërgjegjshme në shërbimin
Kjo VP është e paraparë në Nenin 353-c të KP.
Veprimi i pandërgjegjshëm mund të përbëhet nga veprime me të cilat shkelet ndonjë dispozitë formale, keqpërdoren autorizimet diskrecionale ose i iket mbikëqyrjes së detyrueshme. Me mënyrë tjetër të veprimit evident të papërgjegjshëm nënkuptohen veprimet e ndryshme të kryerjes së detyrës në mënyrë jo të drejtë dhe jo etike (në kundërshtim me normat e etikës profesionale të zyrtarëve për veprim në rast të

korrupsionit të mundshëm, konfliktit të interesave). Pasoja e kësaj vepre është krijimi i disa përfitimeve për vete ose për dikë tjetër. Është paraparë dënim me burg prej tre muaj deri në tre vjet për veprim të papërgjegjshëm të personave zyrtarë.

VP – Zbulimi i sekretit zyrtar

Kjo VP është e rregulluar me nenin 360 të KP.

Subjekti i kësaj vepre është personi zyrtar, ndërsa veprimi që e kryen është të kumtojë, dorëzojë ose në mënyrë tjetër t'i bëjë të qasshme të dhënat që përfaqësojnë sekret zyrtar për publikun ose për personin e paautorizuar ose për të siguruar të dhëna të tilla me qëllim që ato t'i kumtojë ose t'ia dorëzojë publikut ose personit të paautorizuar. Ligji parashikon dënim me burg prej tre muaj deri në pesë vjet. Si sekret zyrtar konsiderohen të dhënat ose dokumentet të cilat me ligj, me ndonjë dispozitë tjetër ose vendim tek organi kompetent të miratuara në bazë të ligjit janë shpallur si sekret zyrtar dhe zbulimi i të cilave ka ose mund të ketë pasoja të dëmshme për shërbimin. Nëse një person e zbulon sekretin zyrtar nga lakmia, respektivisht për realizimin e dobisë pasurore ose për shfrytëzim të të dhëna jashtë vendit, është paraparë dënim me burg prej së paku një viti.

VP – Larja e parave dhe i prurjeve tjera nga veprat e dënueshme

Vepra është e rregulluar me nenin 273 të KP dhe buron nga obligimet e shtetit të ndërmarra me marrëveshjet e ratifikuara ndërkombëtare. Te kjo vepër, rëndësi thelbësore ka objekti, e ato janë para apo pasuri tjetër të cilën kryerësi e ka fituar përmes një vepre të dënueshme ose për të cilën ai e di se janë krijuar me vepër të dënueshme. Me këtë vepër janë inkriminuar më shumë veprime respektivisht ekzistojnë disa forma të kësaj vepre:1) Kur shkelësi lëshon

në shitje ose qarkullim, pranon, merr përsipër, shkëmben ose imtëson të holla ose asete tjera të fituar në mënyrë të kundërligjshme, ose kur në një mënyrë tjetër fsheh se ato rrjedhin nga një burim i tillë ose e fsheh vendndodhjen e tyre, lëvizjen ose pronësinë. 2). Kur shkelësi posedon ose përdor pronë ose sende për të cilat ai e di se janë fituar me kryerje të veprës penale ose falsifikim të dokumenteve, mos-raportim të faktet ose në një mënyrë tjetër do të fsheh se vijnë nga një burim i tillë, ose do ta fshehë vendndodhjen e tyre, lëvizjen dhe pronësinë. Për veprime të tilla parashikohet dënim me burg prej një deri në dhjetë vjet. 3) Format e kualifikuara të veprës ekzistojnë në rastet kur vepra është kryer në punën bankare, financiare apo ndonjë pune tjetër ekonomike, ose në qoftë se me ndarje të transaksionit, kryerësi shmang detyrim ligjor për çka do të dënohet me burg prej së paku tre vjet. 4) Kryerësi, i cili ka qenë i obliguar dhe ka mundur ta dijë se paratë, prona dhe të ardhurat tjera nga vepra penale janë siguruar nëpërmjet veprës penale, do të dënohet me gjobë me para ose me burg deri në tre vjet. 5) Nëse vepra kryhet nga një grup ose shoqatë kriminale e organizuar që merret me pastrimin e parave, anëtari i grupit dënohet me burg prej së paku pesë vjetësh. 6) Personi zyrtar, personi i cili kryen punë me interes publik, personi përgjegjës në bankë, kompani sigurimesh dhe personat e tjerë juridikë të paraparë me ligji, që do të mundësojë ose do të lejojë transaksion ose raport afarist të paligjshëm, dënohet me burgim prej së paku pesë vjet. 7) Personi zyrtar, përgjegjës në bankë ose në një institucion tjetër financiar, ose personi i cili kryen punë me interesit publik, i cili me ligj është i autorizuar të marrë masa dhe veprime për të parandaluar pastrimin e parave dhe të ardhurave të tjera të veprës së dënueshme, ndërsa i cili në mënyrë të paautorizuar do t'i zbulojë klientit ose një personi të paautorizuar të dhëna që kanë të bëjnë me procedurën për shqyrtimin e transaksioneve

të dyshimta ose të zbatimit të masave dhe veprimeve tjera për parandalimin e pastrimit të parave, do të dënohet me burg prej tre muaj deri në pesë vjet. 8) Në qoftë se vepra është kryer nga lakmia ose për shfrytëzim të të dhënave jashtë vendit, kryerësi dënohet me burg prej së paku një vjet. Prurja konfiskohet, dhe në qoftë se konfiskimi nuk mund të bëhet nga kryerësi, atëherë konfiskohet pronë tjetër proporcionale me vlerën e saj.

VP – Përvetësimi i shërbimit
Kjo VP është e rregulluar me nenin 356 të KP.
Një person zyrtar i cili në mënyrë të paautorizuar shërbehet me para, letra me vlerë ose sende të tjera të luajtshme që i janë besuar atij në shërbim ose këto sende pa autorizim do t'ia japë një tjetri për tu shërbyer, dënohet me burgim prej tre muaj deri në pesë vjet.

VP – Ryshfet gjatë zgjedhjeve dhe votimeve
Kjo vepër është e paraparë me nenin 162 të KP.
Si kryerës mund të paraqitet cilido person, e jo vetëm personi zyrtar, i cili personit me të drejtë vote i ofron, i jep ose i premton një dhuratë ose përfitim tjetër, me qëllim që ta përvetësojë që ta kryejë, të mos e kryejë ose si ta kryejë të drejtën e tij të votimit. Veprën mund ta kryejë edhe personi që është bartës i së drejtës zgjedhore dhe i cili për vete kërkon ose pranon dhuratë ose ndonjë dobi tjetër, që ta ushtrojë, të mos e ushtrojë ose si ta ushtrojë të drejtën zgjedhore. Për një sjellje të tillë të kundërligjshme, ligji parashikon burgim prej së paku pesë vjetësh. Nëse përfitimi është me vlerë më të vogël, kryerësit do t'i shqiptohet gjobë me para ose me burgim deri në një vit. Në rastet kur veprën e kryer një person juridik, dënohet me gjobë me para.

VP – Pranimi i shpërblimit për ndikim kundërligjor VP – Dhënia e shpërblimit për ndikim kundërligjor

VP e parë është parashikuar në nenin 359 KP.

Si kryerës paraqitet cilido person që drejtpërdrejt ose tërthorazi pranon një shpërblim, dhuratë apo përfitim tjetër ose premtim ose ofertë për një përfitim të tillë, për vete ose për një palë të tretë, që duke përfituar nga ndikim i tij real apo i supozuar, pozita zyrtare ose shoqërore dhe reputacioni, kërkon, ndërhyn, nxit ose në një mënyrë tjetër ndikon që të keqpërdoret shërbimi respektivisht që: 1) të kryhet veprim zyrtar që ka qenë patjetër të kryhet ose të mos kryhet veprim që nuk ka guxuar të kryhet (shfrytëzim i pozitës zyrtare) ose 2) të kryet veprim zyrtar që nuk guxon të kryhet apo të mos kryhet veprim zyrtar që doemos të kryhej (tejkalimi i pozitës zyrtare). Dënimi për një sjellje të këtillë është burg prej një deri në tre vjet. Në qoftë se veprimi i aktit është bërë në lidhje me ngritjen apo udhëheqjen e procedurës penale kundër një personi të caktuar, është paraparë burgim prej një deri në pesë vjet dhe ndalim për personin zyrtar që të kryejë detyrën e vet për një periudhë prej një deri në dhjetë vjet. Ligji parashikon përgjegjësi edhe në rastin kur veprimi i kryerjes është drejtuar ndaj një personi përgjegjës, personi përgjegjës në një subjekt të huaj juridik që ushtron veprimtari në Republikën e Maqedonisë ose person që kryen punë me interes publik, ndërsa është paraparë gjobë me para ose dënim me burg deri në një vit. Përveç formës themelore, është paraparë edhe forma kualifikuese kur për pasojë vepra ka pasur marrjen ose humbjen e ligjshme të të drejtave, ose fitim më të madh të dobisë pronësore ose shkaktim të dëmit më të madh për tjetërkënd, në të cilin rast dënimit me burg lëviz nga një deri në pesë vjet. Për këtë punë parashihet përgjegjësi edhe e personit juridik.

Pandan të pranimit paraqet dhënia e shpërblimit për ndikimin të kundërligjshëm, VP e cila është e inkriminuar me

nenin 358-a të KP. Këto dy vepra janë identike për nga natyra, veprimi i kryerjes dhe objekti i mbrojtjes, me atë dallim që te pranimi kryerësi është në një rol pasiv, ndërsa te dhënia kryerësi është në një rol aktiv dhe jep shpërblim, dhuratë apo përfitim tjetër ose premtim, për veten ose për të tjerët, në mënyrë që të arrijë abuzim dhe shfrytëzim të pozitës zyrtare. Nëse vepra është kryer me kërkesë të personit i cili duhet të ndërmjetësojë në mënyrë të kundërligjshme, ndërsa kryerësi e a denoncuar para se të zbulohet ose para se ta kuptojë se është zbuluar mund të lirohet nga dënimi. Shpërblimi, dhurata ose përfitimet tjera do të konfiskohen.

VP – Pranimi i ryshfetit

Kjo VP është e rregulluar me nenin 357 të KP.

Marrja e ryshfetit (shih edhe dhënia e ryshfetit) paraqet formë klasike dhe më të shpeshtë të sjelljes korruptive, me të cilën bartësit e autorizimeve zyrtare dhe publik, në mënyrë të paligjshme dhe të palejuar dhe me keqpërdorim të pozitës së tyre, fitojnë dobi pasurore dhe privilegje. Veprimi i zbatimit në këtë VP mund të përbëhet nga ndërmarrja ose mos-ndërmarrja e veprimi zyrtar. Nuk ekziston ryshfet nëse një person merr dhuratë ose premtim për dhuratë që të kryejë një veprim që nuk është zyrtar. Kjo do të thotë se si kryerës i kësaj vepre mund të paraqitet kryekëput personi zyrtar. Janë të inkriminuara tri forma themelore të ryshfetit, edhe atë: 1) Kur personi zyrtar kërkon ose merr dhuratë apo premtim për dhuratë apo përfitim tjetër që të ndërmarrë veprim zyrtar që nuk do të guxonte ta kryejë apo që të mos ndërmarrë ndonjë veprim të cilin përndryshe doemos ta kryejë (tejkalimi i autorizimeve zyrtare). Për këtë vepër do të dënohet me burgim prej një deri në pesë vjet. 2) Kur personi zyrtar do të veprojë në kundërshtim me ligjin ashtu që do të kryejë një veprim të caktuara që patjetër do të duhej ta kryejë, ose kur nuk do të kryejë veprimin të cilin nuk do të guxonte ta kryejë (shfrytëzimi i autorizimeve zyrtare). Për

këtë vepër parashikohet dënim me burg prej katër deri në dhjetë vjet. 3) Korruptim plotësues kur personi zyrtar kërkon, pranon ose bie dakord që të pranojë një dhuratë apo përfitim tjetër pas veprimit sipas njërës nga mënyrat e përshkruara më sipër do të përballet me një dënim me burg prej tre muaj deri në tre vjet. Në qoftë se me veprën sigurohet përfitim më i madh ose i konsiderueshëm pasuror, kryerësi do të dënohet me burgim prej së paku 4 respektivisht 5 vjet. Përveç kësaj, kryerësit do t'i ndalohet kryerja e detyrës zyrtare në kohëzgjatje nga një deri në dhjetë vjet dhe dobia e fituar pasurore do t'i konfiskohet. Krahas personit zyrtar, përgjegjësi për marrjen e ryshfetit mund të bartë edhe personi përgjegjës në subjektin juridik ose personi që kryen punë me interes publik dhe personi i huaj zyrtar.

VP – Abuzim në shërbim

Kjo VP është e rregulluar me nenin 354 të KP.

Abuzimi në shërbim nënkupton marrjen për vete ose për tjetërkënd dobi pasurore të kundërligjshme, në mënyrën që personi zyrtar do të përvetësojë para, letra me vlerë ose sende tjera të luajtshme të besuara në shërbim. Për këtë vepër parashikohet dënim me burg prej gjashtë muaj deri në tre vjet. Në qoftë se me kryerjen e veprës sigurohet dobi më e madhe pasurore ose shkaktohet dëm i konsiderueshëm pronësor ose më rëndë shkelen të drejtat e tjetrit, dënimi është burgim nga gjashtë muaj deri në pesë vjet. Në rast ku dobia e fituar pasurore është e konsiderueshme, dënimi është të paktën katër vjet burg, ndërsa për dobi të vogël pasurore është paraparë gjobë me para ose dënim me burg deri në një vit

VP – Pagesë dhe arkëtim kundërligjor

Kjo VP është e rregulluar me nenin 362 të KP.

Arkëtim t kundërligjshëm ka kur personi zyrtar do të arkëtojë shumë të cilën ai nuk është i obliguar ta paguajë

ose do t'i arkëtojë më shumë se sa personi është i obliguar të paguajë. Ndërsa me pagesë të kundërligjshme kemi të bëjmë kur gjatë pagesës ose dorëzimit të sendeve personi zyrtar do të paguajë ose do të dorëzojë më pak se sa që ka qenë i obliguar. Për këtë vepër është paraparë dënim me burg deri në tre vjet.

VP – Fitimi dhe fshehja jolegjitime e pronës

Kjo VP është e parashikuar në nenin 359-a të KP.

Subjekt i veprës është personi zyrtar ose personi përgjegjës në ndërmarrje publike, institucion publik apo ndonjë subjekt tjetër juridik që disponon me kapital shtetëror, ndërsa veprimi i ekzekutimit konsiston në fshehjen ose mos-raportimin e gjendjes pasurore ose ndryshimin e saj dhe dhënien e informatave të rremë ose jo të plota mbi pronën e vet ose të anëtarëve të familjes së tij. Për këtë vepër parashikohet dënim me burg prej gjashtë muaj deri në pesë vjet dhe gjobë me para. Dënimi shqiptohet kur do të konstatohet se gjatë ushtrimit të funksionit dhe detyrës e personi ose anëtari i familjes së tij ka fituar pronën që në një vlerë të konsiderueshme i tejkalon të ardhurat e tij ligjore, ka dhënë informacione të rreme apo ka fshehur burimet e vërteta të të ardhurave. Në rastet kur pasuria është rritur në përmasa të mëdha, kryerësit i shqiptohet dënim me burg prej një deri në tetë vjet dhe gjobë me para. Përveç kumulimit ndëshkimit me burg dhe me para, parashikohet edhe konfiskimi i pronës.

Veprat penale të korrupsionit

Me Kodin Penal janë paraparë disa vepra penale kundër detyrës zyrtare, ku si më të rëndësishëm janë me sa vijon: abuzimi me pozitën zyrtare dhe autorizimin, mitëmarrja, mitëdhënia, keqpërdorim i procedurës për shpallje publike, ndarja e kontratës për prokurim publik ose partneritet publik-privat, marrja dhe dhënia e paautorizuar e dhuratave, puna e

pandërgjegjshme brenda shërbimit, zbulimi i sekretit zyrtar, evazionin fiskal, ryshfeti në zgjedhje dhe votime, marrja dhe dhënia e shpërblimit për ndikim të kundërligjshëm, abuzim në shërbim, përvetësim në shërbim, mashtrim në shërbim, arkëtim dhe pagesë e kundërligjshme, fitim dhe fshehje e paligjshme e pasurisë, pastrim parash dhe të ardhurave të tjera nga veprat e dënueshme etj.

Veprat penale kundër pozitës zyrtare

Këto vepra penale, si vepra kryesore korruptive, janë rregulluar në Kapitullin 30 të Kodit Penal dhe quhen vepra zyrtare ose vepra nëpunësish. Gjithashtu, ky lloj i veprave penale janë të përfshira edhe në kapitujt tjerë të KP, siç është kapitulli i VP kundër lirive dhe të drejtave të qytetarëve. Si një kategori gjenerike, ato i kanë karakteristikat e mëposhtme kryesore: janë të orientuara kundër pozitës zyrtare, kryhen gjatë ushtrimit të detyrës ose autorizimit dhe ati i kryen personi zyrtar. KP nuk e definon termin "detyrë zyrtare". Në teorinë dhe praktikën juridike, ky term konsiderohet si kategori dinamike dhe përfshin kryerjen e një game të gjerë të kompetencave dhe punëve që lidhen me funksionet e organeve të pushtetit shtetëror (legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor), si dhe kryerjen e autorizimeve publike në subjektet juridike që kanë funksione publike (ndërmarrjet publike, shërbimet shëndetësore, komunale dhe shërbimet tjera publike). Nga ana tjetër, krahas personave zyrtarë, si kryerës të këtyre veprave mund të paraqiten edhe bartësit e funksioneve publike dhe personat përgjegjës. Sipas praktikës gjyqësore, si kriter për të vlerësuar nëse një person konsiderohet si person zyrtar apo jo, merret parasysh autonomia e personit në kryerjen e detyrave të caktuara zyrtare dhe të autorizimeve të tija për të menaxhuar dhe për të vendosur.

Vendimet në procedurën penale

Në procedurën penale ekzistojnë këto lloje të vendimeve: aktgjykim, aktvendim dhe urdhër. Aktgjykim mund të

sjellë vetëm gjykata, ndërsa vendim dhe urdhër mund të sjellin edhe organet e tjera që marrin pjesë në procedurën penale. Kryerësit të veprës penale mund t'i shqiptohet sanksion vetëm nga gjykata kompetente në procedurë të zbatuar në pajtim me LPP.

Viktima

Viktimë e veprës penale është çdo person që ka pësuar dëm, duke përfshirë lëndime fizike ose mendore, vuajtje emocionale, humbje materiale ose shkelje të tjera ose një person të drejtat dhe interesat e të cilit janë të rrezikuara si rezultat i veprës së kryer. Viktima ka të drejtën e kompensimit për dëmin e pësuar, që përfshin dëmin material dhe jomaterial, të cilën të drejtë ai mund ta realizojë duke parashtruar kërkesë pronësore-juridike në procedurën e rrjedhëse penale ose duke iniciuar procedurë kontestimore ose qytetare (shih më shumë për kërkesat pronësore-juridike).

Vlerësimi ose kontrollimi i prokurorisë

Si fazë obligative në procedurën penale, vlerësimi ose kontrolli kryhet pavarësisht nëse i pandehuri dhe mbrojtësi i tij kanë paraqitur kundërshtim kundër aktit të prokurorisë apo jo. Kontrollin e aktakuzës të parashtruar për vepra penale për të cilat është caktuar dënim me burg deri në 10 vjet, e bën gjyqtari për vlerësim të aktakuzës, ndërsa për veprat penale për të cilat është caktuar dënim prej më shumë se 10 vjet, kontrollin e bën këshilli për vlerësim të aktakuzës i përbërë prej tre gjyqtarëve. Gjyqtari ose këshilli për vlerësimin e aktakuzës nuk mund të veprojnë si gjyqtar gjykues në të njëjtin rast.